**Silvana Nini**

# LIBËR PËR MËSUESIN
# ARTI PAMOR 8

**BOTIME**

pegi

# Përmbajtja

**1. Hyrje** **4**
**1.1** Pse shërben ky libër? 5
**1.2** Çfarë synon ky libër? 5
**1.3** Çfarë përmban ky libër? 5

**2. Kompetencat dhe kuptimi i tyre** 6

**2.1** Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave lëndore dhe i tematikave që zhvillohen në lëndën e Artit pamor 6
**2.2** Lidhja e lëndës së artit pamor me fushat e tjera kurrikulare. 11

**3. Planifikimi i kurrikulës – kuptimi dhe zbatimi** 13
**3.1** Plani vjetor i lëndës "Art pamor", sipas tremujorëve 14
**3.2** Planifikimi tematik për tremujorin e parë (shtator-dhjetor) 17
**3.3** Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (shtator-dhjetor) 28
**3.4** Planifikimi tematik për tremujorin e parë, (janar-mars) 50
**3.5** Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (janar-mars) 60
**3.6** Planifikimi tematik për tremujorin e parë (prill-qershor) 79
**3.7** Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (prill-qershor) 91

**4. Metodologjia e mësimdhënies** 108
**4.1** Metodologjia e të nxënit dhe e mësimdhënies bazuar në kompetenca në lëndën e artit pamor 108
**4.2** Materiale dhe burime mësimore 110

**5. Vlerësimi** 111
**5.1** Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar 111

# 1. Hyrje

Lënda "Arti pamor" është një lëndë e veçantë me kërkesat e veta specifike të të mësuarit. Veprimtaritë e "Artit pamor" bëjnë të mundur që nxënësit të bëjnë lidhjen midis botës reale dhe asaj imagjinare, të organizojnë dhe të shprehin vizualisht idetë, ndjenjat dhe përvojat nëpërmjet teknikave të larmishme artistike.

Edukimi nëpërmjet "Artit pamor" siguron zhvillimin e krijimtarisë dhe të përvojave personale nëpërmjet zbulimit, kërkimit, eksperimentimit dhe përdorimit të një sërë mjetesh dhe teknikash artistike. Kjo lëndë promovon vëzhgimin dhe i ndihmon nxënësit të fitojnë ndjeshmëri për botën pamore. Në artin pamor imazhi mund të marrë forma të ndryshme, në varësi të mjeteve dhe të materialeve që përdoren për ta realizuar atë. Imazhi mund të jetë dy ose tredimensional, abstrakt ose figurativ, dinamik ose statik etj. Ai krijohet duke përdorur teknika të ndryshme artistike. Përzgjedhja e materialeve dhe organizimi i gjuhës pamore në një vepër varen nga mesazhi që ajo do të komunikojë.

Edukimi, nëpërmjet lëndës së artit pamor, nxit zhvillimin e përgjithshëm të nxënësit/es dhe pasuron kulturën e tij. Kjo lëndë i ndihmon nxënësit/et të deshifrojnë mesazhet pamore, të vëzhgojnë imazhet me një ndjeshmëri më të lartë, të ushtrojnë mendimin kritik dhe ndjenjën estetike. Sot në kulturën edukative i kushtohet shumë rëndësi pranisë së imazhit dhe në këtë drejtim artet pamore luajnë një rol themelor në zhvillimin social, ekonomik dhe artistik të nxënësve/eve.

Duke u mbështetur në kërkesat e programit, libri i artit pamor i klasës së tetë bazohet në tri kompetenca: krijimi artistik, realizimi i punimit dhe vlerësimi i veprave të artit. Ky libër i orienton nxënësit/et të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues, duke zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën pamore për të komunikuar mendimin e ndjenjat e tyre.

## 1.1 Pse shërben ky libër?

Ky libër do t'u shërbejë mësuesve/eve të artit pamor, si një material mbështetës për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale në këtë lëndë, për zbatimin më së miri të risive në kurrikulën e artit pamor.

## 1.2 Çfarë synon ky libër?

Meqenëse arsimi po zbaton mësimdhënien bazuar në ***kompetenca***, ky libër do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit/et e artit pamor që do ta ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *kornizën kurrikulare, kurrikulën-bërthamë të arteve, programin mësimor* dhe vlerësimin bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave në arte,* të cilat përkojnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

a) planifikimin e të nxënit;
b) metodologjinë e mësimdhënies;
c) vlerësimin e të nxënit bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Qëllimi i këtij libri është t'i orientojë mësuesit/et e klasës së tetë dhe t'i ndihmojë që të përmbushin synimet e kurrikulës së artit pamor, të ndërtojnë kompetencat lëndore te nxënësit/et e klasës së tetë, të planifikojnë dhe të realizojnë detyrat e tyre si mësimdhënës/e së kësaj lënde, në përputhje me dokumentet zyrtare dhe me fazat nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

## 1.3 Çfarë përmban ky libër?

Ky libër është konceptuar në përputhje me draft-programin e klasës së tetë, të shkallës së katërt të lëndës "Arti pamor", miratuar nga MAS-i dhe merr përsipër:

- të sqarojë çdo mësues/e të artit pamor për të gjitha çështjet e planifikimit, të metodologjisë dhe të vlerësimit që duhet të zbatojnë çdo ata/ato lëndën e tyre;
- të paraqesë dokumentet e hartuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren nga vetë mësuesi/ja në lëndën e artit pamor në klasën e tetë;
- të udhëzojë për të gjitha formatet e reja: planin vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, formatet e vlerësimit etj., me të cilat duhet të punojë mësuesi/ja gjatë një viti shkollor.

Ky libër në parim jep, ofron ose sugjeron modele, por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, situatat e të nxënit, metodologjinë apo

vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim. Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

# 2. Kompetencat dhe kuptimi i tyre

Kjo çështje ka si qëllim kuptimin:

- për krijimin e kushteve për ndërtimin e ***kompetencave të lëndës*** së ***artit pamor*** si dhe të ***kompetencave kyçe***, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën;
- për realizimin e ***temave ndërkurrikulare*** nëpërmjet lëndës së artit pamor, i cili është gjithashtu një përbërësi rëndësishëm i programit të artit pamor;
- për kontributin e artit pamor në shoqëri dhe në jetën e përditshme.

Në këtë modul, gjithashtu, përshkruhet ***lidhja e artit pamor me fushat e tjera kurrikulare***, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë të formimit të nxënësve/eve.

Arti pamor zhvillohet në të gjithë arsimin e detyruar përmes 4 shkallëve,që përfshijnë *arsimin fillor* (AF) klasat 1-5 dhe *arsimin e mesëm të ulët (AMU)* klasat 6-9, pra dy cikle arsimimi, të cilat përfshijnë brenda tyre nëntë vite shkollimi.

Këto katër shkallë grupohen në mënyrë të tillë:

- ***shkalla e parë:*** klasa përgatitore (mosha parashkollore 5-6 vjeçare) – klasa dytë;
- ***shkalla dytë:*** klasa e tretë – klasa e pestë;
- ***shkalla e tretë:*** klasa e gjashtë – klasa e shtatë;
- ***shkalla e katërt:*** klasa e shtatë – klasa e tetë.

## 2.1 Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave lëndore dhe i tematikave që zhvillohen në lëndën e Artit pamor

**Qasja e bazuar në kompetenca** është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në fushën e arteve në përgjithësi (në të gjitha shkallët) dhe që ndërtohet përmes kompetencave të kësaj fushe, të cilat janë: **krijimi, realizimi dhe vlerësimi**. Në të gjitha shkallët e kurrikulës, ato zhvillohen dhe plotësohen më tej me **kompetencat specifike lëndore të artit pamor brenda** fushës së arteve. Kompetencat lëndore të artit pamor lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me **kompetencat kyçe.** Ato janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së artit pamor dhe zhvillohen nëpërmjet tyre.

Zotërimi i artit pamor nënkupton ***zotërimin e kompetencave pamore***, që do të thotë aftësi për të kuptuar, për të gjykuar e për të përdorur artin pamor në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh, jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata të tjera, në të cilat ky art luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm. Me kurrikulën e re, arti pamor është strukturuar me tri (3) kompetenca, të cilat renditen si më poshtë:

## *Kompetenca 1*

***Krijimi artistik ka të bëjë me:***

- përdorimin e ideve dhe organizimin e gjuhës pamore në një krijim artistik;
- përdorimin e mjeteve dhe të teknikave artistike për realizimin e ideve nëpërmjet gjuhës pamore;
- vlerësimin e ideve krijuese dhe ndarjen e përvojave me të tjerët.

## *Kompetenca 2*

***Realizimi i punimit, ka të bëjë me:***

- kuptimin dhe zbatimin e teknikave të larmishme artistike dy dhe tredimensionale për realizimin e ideve krijuese nëpërmjet gjuhës pamore;
- përdorimin e teknikave dhe të proceseve artistike, si dhe me ndarjen e përvojave me të tjerët.

## *Kompetenca 3*

***Vlerësimi i veprave të artit, ka të bëjë me:***

- kuptimin dhe analizimin e veprave artistike, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik, që i përgjigjet kësaj grupmoshe.

**Tabela e kompetencave lëndore të artit pamor dhe përshkrimi i tyre**

| Kompetencat e artit pamor | Përshkrimi i kompetencave lëndore |
|---|---|
| **Krijimi artistik** | Nxënësi/ja:<br>• përdor ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim;<br>• zbulon rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike;<br>• përdor hapat e procesit krijues, elementet e artit pamor dhe teknikat artistike;<br>• përzgjedh elementet e duhura për të realizuar idetë artistike në tema të personalizuara;<br>• përmirëson punën, duke u mbështetur tek eksperimenti dhe te zgjidhjet e ndryshme artistike;<br>• analizon burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin e tij/saj krijues;<br>• identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në krijim, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur. |
| **Realizimi i punimit** | Nxënësi/ja:<br>• përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë në punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn;<br>• krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit etj., ose nëpërmjet imagjinatës, duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike;<br>• vlerëson eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit;<br>• zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim;<br>• eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tij/saj;<br>• analizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij/saj krijues;<br>• identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në lidhje me realizimin e punimit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur. |

| Kompetencat e artit pamor | Përshkrimi i kompetencave lëndore |
|---|---|
| **Vlerësimi i veprave të artit** | Nxënësi/ja:<br>• analizon dhe interpreton elementet e gjuhës vizuale, organizimin e tyre, teknikën dhe gjininë në një vepër arti;<br>• identifikon dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social-kulturor;<br>• identifikon dhe argumenton aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, atë të punës së tij/saj dhe të shokut/shoqes, duke shprehur emocionet e tij/saj;<br>• interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër arti, për një objekt artistik, për punimin e tij/saj dhe atë të shokut/shoqes;<br>• përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, atë të shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike;<br>• identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në vlerësimin e veprave të artit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur;<br>• kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe të artistit në shoqëri në periudha të ndryshme historike;<br>• identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karrierën artistike. |

## *Tematikat që përshkojnë lëndën e artit pamor*

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë *tri kompetencat e lëndës*, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës/e duhet të zotërojë gjatë jetës së tij/saj, dhe që arrihen nëpërmjet *tri tematikave kryesore*. ***Tematikat përmbajtjesore,*** janë ato tematika që zhvillohen përgjatë programit dhe krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë *njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet* dhe *vlerat*, në funksion të *kompetencave të lëndës* dhe të *kompetencave kyçe*. Për çdo tematikë janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të çdo shkalle përkatëse. Përshkrimi i secilës **tematikë** dhe përshkrimi i **kompetencave lëndore,** që duhet të shfaqë nxënësi/ja lidhur me tematikat përkatëse, paraqiten vetëm në nivel shkalle.

<table>
<tr><th>TEMATIKAT E ARTIT PAMOR</th><th>KOMPETENCAT E ARTIT PAMOR</th></tr>
<tr><td>Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi artistik.<br>Nxënësi/ja:<br>• zbulon elementet e gjuhës vizuale në mënyrë personale dhe i përdor për të realizuar idetë e veta përmes imazheve;<br>• përdor me kompetencë hapat e procesit krijues që nga stimuli, ideja dhe realizimi, nëpërmjet përzgjedhjes së teknikave të duhura artistike;<br>• procesi i eksperimentit është pjesë e rëndësishme e krijimit artistik pasi ndihmon në aftësimin e nxënësit, për të personalizuar tema e subjekte të ndryshme;<br>• personalizimi i temave dhe subjekteve dhe përdorimi i qëllimshëm i elementeve të gjuhës artistike është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit krijues;<br>• bëhet i ndërgjegjshëm dhe i pavarur në përdorimin e gjuhës pamore dhe në komunikimin e ideve origjinale.<br>• zbulon ide të reja, përdor burime të ndryshme informacioni, bën skica dhe përcakton qëllimin krijues.</td><td rowspan="2">Kompetenca 1: Krijimi artistik<br><br>Kompetenca 2: Realizimi i punimit</td></tr>
<tr><td>Tematika 2: Teknika dhe procese artistike.<br>Nxënësi/ja:<br>• krijon punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn, nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike;<br>• zbulon mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, tradicionale dhe digjitale, eksperimenton dhe i përdor me kompetencë në realizimin e punimit;<br>• eksperimenton me efektet e ndryshme të tyre për të realizuar idenë dhe për të dhënë mesazhin për një audiencë të caktuar;<br>• zhvillon aftësitë e tij për të organizuar gjuhën vizuale nëpërmjet teknikave të ndryshme artistike dhe ndan eksperiencat krijuese me të tjerët;</td></tr>
</table>

| TEMATIKAT E ARTIT PAMOR | KOMPETENCAT E ARTIT PAMOR |
|---|---|
| • bëhet i ndërgjegjshëm dhe i pavarur në përdorimin e teknikave të ndryshme artistike dhe realizimin e ideve origjinale;<br>• zbulon, gjatë procesit krijues, mundësitë e shumta shprehëse që ofrojnë teknikat artistike dy dhe tredimensionale;<br>• përdor burime të ndryshme informacioni, eksperimenton dhe përcakton qëllimin krijues. | |
| **Tematika 3: Historia, arti dhe shoqëria.**<br>Nxënësi/ja:<br>• analizon dhe interpreton vepra të ndryshme arti dhe objekte të trashëgimisë kulturore në aspektin historik dhe social-kulturor;<br>• përshkruan, analizon dhe interpreton gjuhën vizuale, teknën, gjininë dhe subjektin në një vepër arti;<br>• komunikon emocionet dhe gjykimin mbi vepra të ndryshme arti si dhe për punën e tij/saj dhe për atë të shokut/shoqes;<br>• vlerëson aspektet e cilësisë simbolike dhe shprehëse të veprave të artit, duke marrë parasysh kontekstin historik të tyre;<br>• përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar eksperiencën e tij/saj artistike dhe atë që ka mësuar nga kjo eksperiencë;<br>• pasuron perceptimin për mjedisin që e rrethon duke e njohur më mirë atë;<br>• kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, respekton opinione estetike dhe kritike të ndryshme dhe identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karrierën artistike. | **Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave të artit** |

## 2.2 Lidhja e lëndës së artit pamor me fushat e tjera kurrikulare.

Arti pamor është i lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Elementet e artit pamor, ritmi, harmonia, dinamika etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike, si: kërcimin, muzikën,

teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën, shkencat shoqërore. Nxënësit/et nxiten të bëhen të vetëdijshëm/me për një numër procesesh që lidhen me karakteristikat kryesore të kompetencave kroskurrikulare, të cilat krijojnë lidhje me njohuritë në lëndët e tjera. Kompetencat e artit pamor i mundësojnë nxënësit/et të përdorin informacionin, të zgjidhin problemin, të ushtrojnë mendimin kritik, të zbulojnë metoda pune efektive, të përdorin informacionin dhe komunikimin teknologjik, të zhvillojnë identitetin e tyre personal, të punojnë me të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë të përshtatshme. Kështu që, edhe në këtë cikël, mësuesit/et përmes mësimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë nxënësve/eve të konsolidojnë përvojat që ata/ato kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të artit pamor me lëndë të tjera, të para përmes objektivave të njohurive:



## 3. PLANIFIKIMI I KURRIKULËS – KUPTIMI DHE ZBATIMI

Planifikimi i kurrikulës është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es, që zgjat përgjatë gjithë vitit shkollor. Përgatitja e dokumenteve që shoqërojnë punën e tij/saj përgjatë vitit janë të shumta dhe kanë të bëjnë me *planifikimin e kurrikulës* dhe *dokumentet* përkatëse. Planifikimi i këtyre dokumenteve të kurrikulës së re nga mësuesi/ja kërkon: liri, elasticitet dhe përgjegjshmëri në planifikim. Këto dokumente janë:

**1.** plani vjetor i lëndës së artit pamor, sipas tremujorëve;
**2.** plani vjetor tematik.

Planifikimi i planit vjetor dhe tremujor bëhet sipas ndarjes së kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i artit pamor, i cili është dhënë në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 3: Orë të sugjeruara për çdo tematikë**

| | Gjuha dhe komunkimi artistik | Teknikat dhe procese | Historia, arti dhe shoqëria | Gjithsej orë |
|---|---|---|---|---|
| **Klasa e tetë** | 10 | 15 | 10 | 35 orë |

Planifikimi vjetor i programit është i ndërtuar me *tremujore*, ku secili tremujor ka një grup të caktuar orësh, në bazë të periudhës kohore të përcaktuar në udhëzimin e çdo fillim viti të ri shkollor .

Temat mësimore në lëndën e artit pamor janë renditur sipas programit, pra çdo tematikë njëra pas tjetrës. Njohuritë ndërthuren në mënyrë mjaft organike me njëra-tjetrën pasi të tria kompetencat pasqyrohen në secilën tematikë.

Më poshtë vijojnë tabelat e:

a) Planifikimi vjetor i lëndës art pamor, sipas tremujorëve
b) Planifikimi tematik për çdo tremujor, i lëndës art pamor
c) Planifikimi ditor

**3.1 Planifikimi vjetor i lëndës "art pamor", sipas tremujorëve.**

| **Tematikat** | Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave | | |
|---|---|---|---|
| | **shtator-dhjetor**<br>**12 orë** | **janar-mars**<br>**12 orë** | **prill-qershor**<br>**11 orë** |
| 1. Gjuha dhe komunikimi artistik<br>**(10 orë)** | **Vija**<br>Vija në pikturë dhe vizatim.<br>**Forma dy dimensionale**<br>Format figurative dhe abstrakte.<br>**Ngjyrat**<br>Kontrasti i ngjyrave.<br>**Tekstura**<br>Tekstura në skulpturë dhe arkitekturë.<br>**Vëllimi**<br>Drita dhe hija: hija dhe perspektiva.<br>**Hapësira (**Paraqitja perspektive e hapësirës).<br>Perspektiva këndore ose me dy pika ikjeje.<br>**Theksi dhe qendra e interesit.**<br>**Proporcionet**<br>Portreti | | |

| Tematikat | Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave | | |
|---|---|---|---|
| | **shtator-dhjetor**<br>**12 orë** | **janar-mars**<br>**12 orë** | **prill-qershor**<br>**11 orë** |
| **2. Teknikat dhe proceset**<br><br>**(15 orë)** | **Vizatimi**<br>– Teknikat grafike: pastelet<br>**Piktura**<br>Teknika piktorike eksperimentale, spruco pikëzime, përzierje materialesh, etj. | **Piktura**<br>– Teknika piktorike eksperimentale, spruco pikëzime, përzierje materialesh, etj.<br>**Stampimi**<br>– Ndërhyrje mbi imazhet e stampuara dhe fotografike.<br>– Teknika stampimi dekorative<br>**Fotografia**<br>– Gjinitë e fotografisë<br>**Grafik dizajni dhe prezantimi**<br>– Imazhi i reklamës<br>**Skulptura**<br>– **Modelimi** me plastelinë, baltë ose karta pesta. (Maska)<br>– **Gdhendja** mbi materiale të buta. (Portret)<br>**Konstruksoni**<br>– Materiale të ndryshme dhe të riciklueshme.<br>(skulpturë me materiale të riciklueshme) | **Konstruksoni.**<br>(moket ndërtese në arkitekturë) |

| Tematikat | Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave | | |
|---|---|---|---|
| | **shtator-dhjetor**<br>**12 orë** | **janar-mars**<br>**12 orë** | **prill-qershor**<br>**11 orë** |
| **3. Historia arti dhe shoqëria**<br><br>**(10 orë)** | | 1<br><br>2<br><br>**3**<br><br>**4**<br><br>**5**<br><br>**6** | **Vepra arti nga periudha të ndryshme** [1]<br>**6.1 Zhvillimi i artit në periudhën:**<br>– Baroke;<br>– Klasike;<br>– Romantike;<br>– Realiste;<br>– Impresioniste.<br>**6.1.1 Zhvillimi i artit në Shqipëri në fund të shek. XIX dhe fillim të shek. XX**<br>**Trashëgimi kulturore**<br>– Veshjet popullore (Shqiptare).<br>**6.1.2 Ekspozita dhe ngjarje kulturore**<br>– Ekspozita, projekte artistike në klasë, shkollë dhe komunitet.<br>**6.1.3 Media**<br>Libra, revista, postera, filma, aparat fotografik, kompjuter etj. |

1. Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore. Ato do të përdoren për të ilustruar njohuritë e marra në tematikat "Gjuha dhe komunikimi artistik" dhe "Teknika dhe procese artistike".

## *3.2 Planifikimi tematik për tremujorin e parë shtator-dhjetor*

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

**Kompetenca e komunikmit dhe të shprehurit**

Nxënësi/ja:

- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike;
- gjykon drejt mesazhet, që u adresohet;
- shprehet qartë dhe saktë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale;
- komunikon qartë mendimin e tij/saj;
- shfrytëzon në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme.

**Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi/ja:

- përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;
- zgjidh në mënyrë të pavarur probleme të ndryshme artistike;
- zhvillon aftësitë për të menduar dhe për të argumentuar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;
- ndjek me vëmendje udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari artistike.

**Kompetenca e të nxënit**

Nxënësi/ja:

- përzgjedh në mënyrë të pavarur mjetet për të realizuar një krijim artistik;
- përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim;
- zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi/ja:

- drejton dhe merr pjesë aktive në aktivitete të artit pamor si brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- kupton dhe gjen zgjidhje në mënyrë të pavarur për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

- diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
- respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
- bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës, për një qëllim të përbashkët.

**Kompetenca personale**

Nxënësi/ja:

- krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike;
- merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe komunitet;

ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit te të tjerët.

**Kompetenca digjitale**

Nxënësi/ja:

- gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
- përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit artistik, si: video CD, DVD, aparat fotografok dixhital, kamera etj.

***Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës***

**Krijimi artistik**

Nxënësi/ja:

përdor ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim;
zbulon rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike;
përdor hapat e procesit krijues, elementet e artit pamor dhe teknikat artistike;
përzgjedh elementet e duhura për të realizuar idetë artistike në tema të personalizuara;
përmirëson punën duke u mbështetur tek eksperimenti dhe në zgjidhje të ndryshme artistike;
analizon burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin e tij/saj krijues;
identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në krijim, identifikon çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

**Realizimi i punit**

Nxënësi/ja:

përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë në punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn; krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra, ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit etj., ose nëpërmjet imagjinatës duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike;
vlerëson eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit;
zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim;
eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tij/saj;
analizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij/saj krijues;
identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike në lidhje me realizimin e punimit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

**Vlerësimi artistik**

Nxënësi/ja:

analizon dhe interpreton elementet e gjuhës vizuale, organizimin e tyre,

teknikën, gjininë në një vepër arti;
identifikon dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social-kulturor;
identifikon dhe argumenton aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, të punës së tij/saj dhe të shokut/shoqes, duke shprehur emocionet e tij/saj;
interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër arti, për një objekt artistik, për punimin e tij/saj apo të shokut/shoqes;
përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, atë të shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike;
identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në vlerësimin e veprave të artit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur;
kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri në periudha të ndryshme historike;
identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karierën artistike.

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Gjuha dhe komunikimi artistik | Vija në pikturë dhe vizatim.<br><br>10.1.4 | **Përdorimi i vijës dhe mjetet për realizimin e saj**<br>Nëpërmjet një vizatimi mësuesi/ja i fton nxënësit/et të gjejnë përdorimin e vijës si siluetë dhe si formë. Në këtë mënyrë nxënësit/et rikujtojnë njohuritë mbi përdorimin e vijës.<br>Në piktura dhe vizatime të ndryshme ata/ato zbulojnë llojet e vijave të përdorura, si rezultat i mjetit të përdorur dhe i qëllimit të artistit. | metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>puna në grup dhe puna individuale;<br><br>hetimi dhe zbulimi;<br><br>zbatime praktike brenda dhe jashtë klase;<br><br>metoda integruese;<br><br>bashkëbisedim;<br>teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues; | Vlerësim diagnostikues: intervistë me një listë treguesish; vetvlerësim me listë kriteresh.<br>Vlerësim për të nxënë: (Vlerësim formues)<br>vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br>vlerësimi i punës në grup;<br>vlerësim mesnxënësish;<br>vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;<br>vlerësimi i detyrave të shtëpisë; | teksti i artit pamor për klasën e VI;<br><br>materiale nga interneti;<br><br>ilustrime veprash arti;<br><br>ilustrime të imazheve nga natyra në përshtatje me tema të caktuara;<br>fotografi të objekteve të artit, dizajnit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore; |
| 2 |  | Format figurative dhe abstrakte.<br><br>10.1.5 | **Forma dhe mënyra e paraqitjes së tyre**<br>Në imazhe të ndryshme nxënësit/et identifikojnë format natyrale dhe ato të krijuara nga njeriu. Ata/ato diskutojnë mbi |  |  |  |

| **Nr.** | **Tematika** | **Temat mësimore** | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | larminë e formave dhe mënyrat e paraqitjes së tyre në vepra të ndryshme arti. | prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK;<br><br>projekte kurrikulare. | vetvlerësim;<br>intervistë me një listë treguesish;<br>vëzhgim me një listë të plotë treguesish;<br>portofol;<br>prezantim me gojë ose me shkrim;<br>projekt kurrikular. | slide/ materiale të krijuara nga mësuesit;<br><br>modele të detyrave nga nxënësit. |
| 3 | | Kontrasti i ngjyrave.<br><br>10.1.6 | **Rrethi i ngjyrave**<br>Nëpërmjet rrethit të ngjyrave nxënësit/et identifikojnë ngjyrat e para, ngjyrat e dyta, ngjyrat e ftohta dhe të ngrohta, tonalitetet dhe intensitetin e ngjyrës. Ata/ato diskutojnë se artistët përdorin mënyra të ndryshme të kombinimit të ngjyrave, | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | në lidhje me mesazhin dhe idenë që duan të përcjellin (Në këtë mënyrë ata rikujtojnë njohuritë mbi ngjyrën). | | | |
| 4 | | Tekstura në skulpturë dhe arkitekturë<br><br>10.1.7<br>10.1.8 | **Shenja të ndryshme për të krijuar teksturën në veprat e artit**<br>Nxënësit/et vëzhgojnë vepra arti të artistëve të ndryshëm që shfaqin karakteristika të veçanta të teksturës. Ata/ato identifikojnë shenjën që ka përdorur artisti për të krijuar teksturën në këto piktura (Në këtë mënyrë ata rikujtojnë njohuritë mbi teksturën në pikturë për ta lidhur me atë në arkitekturë). | | | |
| 5 | | Drita dhe hija: hija dhe perspektiva.<br>10.1.9 | **Hija ndryshon sipas burimit të dritës.**<br>Nëpërmjet fotografive të ndryshme nxënësit/ | | | |

| Nr. | **Tematika** | **Temat mësimore** | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | et kuptojnë si ndryshon hija e objektit dhe hija e mbartur. Ata/ato identifikojnë burimin e dritës mbi objekte në imazhe të ndryshme(Në këtë mënyrë ata/ato rikujtojnë njohuritë mbi burimin e dritës dhe mënyrën si shfaqet vëllimi i objekteve si rezultat i këtij burimi). | | | |
| 6 | | Perspektiva këndore ose me dy pika ikjeje.<br>10.1.10<br>10.1.11<br>10.1.10<br>10.1.13<br>10.1.14 | **Nga perspektiva qëndrore (me një pikë) te perspektiva me dy pika ikje.**<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të gjejnë vijën e horizontit dhe pikën e ikjes në imazhin e një kubi të vizatuar në perspektivë. Më pas mësuesi/ja i pyet nxënësit/et se si mund të realizohet kubi në | | | |

| Nr. | **Tematika** | **Temat mësimore** | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | perspektivë duke e parë nga këndi? Mësuesi/ja shfaq imazhin e kubit në perspektivën me dy pika ikje dhe i fton nxënësit të diskutojnë duke e krahasuar atë me kubin e vizatuar me një pikë ikjeje. | | | |
| 7 | | Theksi dhe qendra e interesit. 10.1.15 | **Momenti ose objekti më i rëndësishëm në një imazh ose vepër arti.** Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të zbulojnë personazhin ose objektin që bie më shumë në sy në një vepër arti. Më pas mësuesi/ja i pyet ata/ato, pse mendojnë se është subjekti më i rëndësishëm. Mësuesi/ja i pyet nxënësit/et sesi veprojnë ata/ato kur duan të theksojnë diçka në veshjen, apo edhe në punimin e tyre. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8 | | Portreti dhe proporcionet<br><br>10.1.16 | **Portreti**<br>Mësuesi/ja shfaq imazhe të disa portreteve në pikturë, në vizatim, në fotografi dhe në skulpturë. Nxënësit/et ftohen të diskutojnë mbi mënyrën si janë paraqitur këta portrete, cilët janë personazhet aty dhe karakteristikat e tyre (Ky mësim i paraprin projektit që vijon në dy orët e tjera, duke shërbyer edhe si faza e parë e projektit). | | | |
| 9 | | Projekt. Dielli dhe hëna me portrete njerëzore. | **Dielli dhe hëna të personifikuara si njerëz.**<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes imazhe të ndryshme nga periudha të ndryshme kohore, ku paraqiten dielli dhe hëna me trajta të portreteve njerëzore. | | | |

| Nr. | **Tematika** | **Temat mësimore** | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nxënësit/et diskutojnë mbi shembuj të ndryshëm të personifikimit gjatë historisë së artit. | | | |
| 10 | | Projekt. Dielli dhe hëna me portrete njerëzore. | **Realizimi i portretit** Nxënësit/et e klasës analizojnë përmasat e portretit për të realizuar “diellin” apo “hënën” e tyre. Më pas ata/ato zgjedhin të realizojnë skicën më të mirë, duke argumentuar pse (përballë ose në profil). | | | |
| 11 | Teknika dhe procese artistike | Teknika e pasteleve | **Mundësitë shprehëse të teknikës së pastelit** Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e pastelit dhe mbi mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike. Nëpërmjet eksperimentit ata/ ato zbulojnë mënyra të ndryshme të përdorimit | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | të kësaj teknike dhe zgjedhin një mënyrë për të realizuar krijimin tyre. | | | |
| 12 | | Teknika e grafitit me pastela | **Mundësitë shprehëse të grafitit me pastela** Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të bëjnë një eksperimet të thjeshtë me ngjyrat e pastelit. Në një letër ata/ato ngjyrosin me disa ngjyra një hapësirë të vogël të saj e më pas e mbulojnë me pastelin e zi. Mësuesi/ja i udhëzon të gërryejnë sipërfaqen me një shkop me majë. Në këtë mënyrë ata/ato zbulojnë karakteristikat e kësaj teknike dhe diskutojnë se grafiti mund të realizohet mbi materiale të ndryshme. | | | |

## 3.3 *Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (shtator-dhjetor)*

1. Planifikimi ditor data.................................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Vija në pikturë dhe vizatim.<br>**6.0.1** | | **Situata e të nxënit: Përdorimi i vijës dhe mjetet për realizimin e saj**<br>Nëpërmjet një vizatimi mësuesi/ja i fton nxënësit/et të gjejnë përdorimin e vijës si siluetë dhe si formë. Në këtë mënyrë nxënësit/et diskujtojnë njohuritë mbi përdorimin e vijës. Në piktura dhe vizatime të ndryshme nxënësit/et zbulojnë llojet e vijave të përdorura, si rezultat i mjetit të përdorur dhe i qëllimit të artistit. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon dhe reflekton mbi cilësinë e vijës në vizatim dhe pikturë në varësi të mjeteve të përdorura;*<br>- *zbulon që nëpërmjet mjeteve të ndryshme realizohet cilësia e dëshiruar e vijës në vizatim dhe pikturë;*<br>- *përdor mjete të ndryshme artistike për të realizuar cilësinë e dëshiruar të vijës në krijim, vizatim, pikturë;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të vijës në krijim.* | | **Fjalët kyçe:**<br>- vija si mjet shprehës;<br>- vija në vizatim;<br>- vija në pikturë. | |

<table>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe në vizatim dhe pikturë që ilustrojnë elementin e vijës;<br>- materiale si: letra vizatimi, lapsa lapustila, penela etj.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nëpërmjet një vizatimi mësuesi/ja i fton nxënësit/et të gjejnë përdorimin e vijës si siluetë dhe si formë. Në këtë mënyrë nxënësit/et diskujtojnë njohuritë mbi përdorimin e vijës. Në piktura dhe vizatime të ndryshme, nxënësit/et zbulojnë llojet e vijave të përdorura, si rezultat i mjetit të përdorur dhe i qëllimit të artistit.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon që vija është një element i artit pamor dhe nëpërmjet saj shprehim mendime pa ndihmën e fjalës, shprehim gjendjen tonë shpirtërore dhe krijojmë objekte të çdo lloj forme. Për të arritur këtë mund të krijojmë vija me karakteristika të ndryshme si: të buta, të forta, agresive etj. Nëpërmjet imazheve të ndryshme në vizatim dhe pikturë, nxënësit/et zbulojnë llojet dhe kombinimet e vijave. Gjithashtu ata/ato zbulojnë edhe rolin e gjestit të artistit në një vepër arti.<br>Nxënësit/et nxiten të përdorin mjete të ndryshme për të realizuar cilësinë e dëshiruar të vijës në krijim. Veprimtaritë në libër shërbejnë si udhëzues për t'u shprehur nëpërmjet vijës. Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et nxiten të flasin për krijimet e tyre dhe të shokëve/shoqeve. Nëpërmjet vijës nxënësit/et kuptojnë që mund të krijojnë kompozime të larmishme.<br>Këto punime ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që nxënësit/et bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.</td></tr>
</table>

2. Planifikimi ditor data.................................

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Format figurative dhe abstrakte.<br>6.0.2</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Forma dhe mënyra e paraqitjes së tyre<br>Në imazhe të ndryshme nxënësit/et identifikojnë format natyrale dhe ato të krijuara nga njeriu. Ata/ato diskutojnë mbi larminë e formave dhe mënyrat e paraqitjes së tyre në vepra të ndryshme arti.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon dhe reflekton mbi vepra të ndryshme arti, figurative dhe abstrakte;<br>- zbulon format figurative dhe format abstrakte si mjete shprehëse në art;<br>- përdor format abstrakte në krijim;<br>- shpreh mendimin e tij/saj mbi format figurative dhe abstrakte në art.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- forma figurative;<br>- forma abstrakte.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të veprave të artit figurative dhe abstrakte;<br>- materiale si: lapsa, letra vizatimi, lapsa me ngjyra ose lapustila.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- mjedisi.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Në imazhe të ndryshme nxënësit/et identifikojnë format natyrale dhe ato të krijuara nga njeriu. Ata/ato diskutojnë mbi larminë e formave dhe mënyrat e paraqitjes së tyre në vepra të ndryshme arti.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon që forma është një element i artit. Forma mund jetë natyrale ose e krijuar nga dora e njeriut, mund të jetë e rregullt ose e çrregullt, mund të paraqitet e sheshtë ose me vëllim dhe mund të jetë gjeometrike ose organike. Gjithashtu, forma mund të jetë fgurative dhe abstrakte. Nëpërmjet imazheve të pikturave figurative (realiste) dhe pikturave abstrakte, nxënësit/et zbulojnë mënyrën e paraqitjes së formës në këto vepra. Nxënësit/et zbulojnë sesi format abstrakte shpesh kthehen në simbole në pikturat abstrakte.<br>Veprimtaria në libër shërben si udhëzues për t'u shprehur nëpërmjet formës. Duke u mbështetur në veprën e Kandinskit, nxënësit/et orientohen të mbështeten në format natyrale për të krijuar një pikturë abstrakte. Zbulimi i formave nga natyra është një burim i mirë për të krijuar kompozime me figura abstrakte.<br>Këto punime ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që nxënësit/et bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

3. Planifikimi ditor data............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Kontrasti i ngjyrave. | | **Situata e të nxënit: Rrethi i ngjyrave**<br>Nëpërmjet rrethit të ngjyrave nxënësit/et identifikojnë ngjyrat e para, ngjyrat e dyta, ngjyrat e ftohta dhe të ngrohta, tonalitetet dhe intensitetin e ngjyrës. Ata/ato diskutojnë se artistët përdorin mënyra të ndryshme të kombinimit të ngjyrave, në lidhje me mesazhin dhe idenë që duan të përcjellin (Në këtë mënyrë ata rikujtojnë njohuritë mbi ngjyrën). | |

| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon rrethin e ngjyrave dhe komunikon njohuritë mbi teorinë e ngjyrave;*<br>- *zbulon dhe reflekton mbi imazhet ku shfaqen kombinime të ndryshme të kontrastit të ngjyrave;*<br>- *përdor kombinime të kontrastit të ngjyrave në punën e tij/saj.*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e kombinimit të ngjyrave në lidhje me mesazhin apo idenë në një vepër arti.* | **Fjalët kyçe:**<br>- kontrasti i ngjyrave;<br>- kontrasti i ngjyrave plotësuese;<br>- kontrasti i ngjyrave të pastra;<br>- kontrasti i bardhë e zisë;<br>- kontrasti i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta. |
|---|---|
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhi i rrethit të ngjyrave;<br>- imazhe të ndryshme nga vepra arti, dizajni apo natyra ku përdoren kontrastet e ngjyrave;<br>- materiale të tilla, si: letër, laps, tempera, penel, gotë me ujë. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>*Lidhje me fushat kurrikulare*:<br>- shkencat e natyrës;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>*Lidhja me temat ndërkurrikulare*:<br>- mjedisi. |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nëpërmjet rrethit të ngjyrave nxënësit/et identifikojnë ngjyrat e para, ngjyrat e dyta, ngjyrat e ftohta dhe të ngrohta, tonalitetet dhe intensitetin e ngjyrës. Ata/ato diskutojnë se artistët përdorin mënyra të ndryshme të kombinimit të ngjyrave, në lidhje me mesazhin dhe idenë që duan të përcjellin (Në këtë mënyrë ata rikujtojnë njohuritë mbi ngjyrën). |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se pjesë e rëndësishme e njohurive mbi teorinë e ngjyrës, përveç atyre që u kujtuan, është edhe kontrasti i ngjyrave. Nëpërmjet skemave të teorisë së ngjyrës dhe imazheve të ndryshme, nxënësit/et zbulojnë përdorimin e kontrastit të ngjyrave dhe karakteristikat e tyre. Veprimtaritë në libër shërbejnë si udhëzues për t'u shprehur nëpërmjet kontrastit të ngjyrave. Nxënësit orientohen të eksperimentojnë me llojet e ndryshme të kontrastit dhe t'i krahasojnë mes tyre për të kuptuar edhe efektet e tyre të veçanta.<br>Pasi mbarojnë, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |

| |
|---|
| ***Vlerësimi i nxënësit*** |
| Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

4. Planifikimi ditor data...................................

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Tekstura në skulpturë dhe arkitekturë | | **Situata e të nxënit: Shenja të ndryshme për të krijuar teksturën në veprat e artit**<br>Nxënësit/et vëzhgojnë vepra arti të artistëve të ndryshëm që shfaqin karakteristika të veçanta të teksturës. Ata/ato identifikojnë shenjën që ka përdorur artisti për të krijuar teksturën në këto piktura (Në këtë mënyrë ata rikujtojnë njohuritë mbi teksturën në pikturë). | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon me vëmendje paraqitjen e teksturës në vepra të ndryshme arti;*<br>- *reflekton mbi imazhet, si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon;*<br>- *zbulon që tekstura në krijim përkon me shenjën e artistit dhe materialet e përdorura;*<br>- *krijon teksturën duke përdorur në mënyrë të qëllimshme shenjën artistike;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të teksturës në skulpturë dhe në arkitekturë.* | | **Fjalët kyçe:**<br>- tekstura në skulpturë;<br>- tekstura në arkitekturë;<br>- shenja e artistit. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që tregojnë mënyrat e realizimit të teksturës në vepra të ndryshme arti, në skulpturë dhe në arkitekturë;<br>- materiale për të krijuar: plastelinë dhe materiale të tjera ndihmëse. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare:**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare*:**<br>- shkencat e natyrës;<br>- teknologjia;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare*:**<br>- mjedisi. |
|---|---|
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et vëzhgojnë vepra arti të artistëve të ndryshëm, që shfaqin karakteristika të veçanta të teksturës. Ata/ato identifikojnë shenjën që ka përdorur artisti për të krijuar teksturën në këto piktura (Në këtë mënyrë ata rikujtojnë njohuritë mbi teksturën në pikturë). | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se në artin pamor, tekstura përkon me shenjën e artistit dhe është një mjet shprehës shumë i rëndësishëm, si në pikturë, vizatim, stampim (me të cilin jemi njohur një vit më parë), por edhe në skulpturë dhe arkitekturë. Nëpërmjet imazheve në skulpturë nxënësit/et zbulojnë teksturën e cila ka lidhje me materialin dhe mjetet e përdorura, por edhe me shenjën e artistit. Ndërsa në arkitekturë tekstura ka lidhje kryesisht me materialet e përdorura dhe kombinimin e tyre. Veprimtaria shërben si udhëzues për t'u shprehur nëpërmjet teksturës. Nxënësit/et orientohen të krijojnë një objekt në plastelinë (p.sh., vazo) dhe teksturën e tij nëpërmjet përzgjedhjes së një motivi e mënyrës së kombinimit të tij. Pasi mbarojnë punën, ata/ato diskutojnë mbi mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Diskutojnë për larminë e shenjave që mund të përdoren për të krijuar teksturën në skulpturë. Nxënësit/et kuptojnë që nëpërmjet mundësive shprehëse të teksturës, mund të krijojnë punime të larmishme.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e:<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës:<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. | |

5. Planifikimi ditor data...........................

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Vëllimi. Drita dhe hija: hija dhe perspektiva. | | **Situata e të nxënit: Hija ndryshon sipas burimit të dritës.**<br>Nëpërmjet fotografive të ndryshme nxënësit/et kuptojnë si ndryshon hija e objektit dhe hija e mbartur. Ata/ato identifikojnë burimin e dritës mbi objektet, në imazhe të ndryshme (Në këtë mënyrë ata/ato rikujtojnë njohuritë mbi burimin e dritës dhe mënyrën si shfaqet vëllimi i objekteve si rezultat i këtij burimi). | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon dhe mbledh detaje për të identifikuar burimin e dritës, hijen e objektit dhe hijen e mbartur;*<br>- *reflekton mbi imazhet si pjesë përbërëse të realitetit që e rrethon;*<br>- *zbulon se hija e objektit mbi sipërfaqe ndjek rregullat e perspektivës;*<br>- *përdor qëllimisht burimin e dritës dhe tonalitetet e dritë hijes në mënyrë shprehëse;*<br>- *vlerëson punën e tij dhe të shokëve.* | | **Fjalët kyçe:**<br>- vëllimi;<br>- hija e objektit;<br>- hija e mbartur;<br>- hija dhe perspektiva. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- fotografi që tregojnë objekte ku duket qartë se nga vjen burimi i dritës;<br>- imazhe që ilustrojnë hijen dhe rregullat e perspektivës;<br>- materiale të tilla, si: letër, laps, lapustila etj. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- shkencat e natyrës;<br>- teknologjia;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>mjedisi. | |

| Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nëpërmjet fotografive të ndryshme nxënësit/et kuptojnë sesi ndryshon hija e objektit dhe hija e mbartur. Ata/Ato identifikojnë burimin e dritës mbi objekte në imazhe të ndryshme (Në këtë mënyrë ata/ato rikujtojnë njohuritë mbi burimin e dritës dhe mënyrën sesi shfaqet vëllimi i objekteve si rezultat i këtij burimi). |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se, kur drita bie mbi një objekt formohen dy lloje hijesh: Hija e objektit – në pjesën ku ai nuk përshkohet nga drita dhe hija e mbartur – në sipërfaqen ku objekti mbështetet. Duke iu referuar fotografive të shfaqura mësuesi/ja shpjegon se, burime të ndryshme të dritës bëjnë të mundur që ne ta perceptojmë vëllimin e objekteve në mënyra të ndryshme. Këtë veti të dritës në lidhje me vëllimin e përdorin artistët në krijim për qëllime të caktuara. Mësuesi/ja shpjegon nëpërmjet imazheve se hija që lëshon objekti mbi një sipërfaqe ndjek rregullat e perspektivës.<br>Veprimtaria shërben si udhëzues për t'u shprehur nëpërmjet dritëhijes. Nëpërmjet vizatimit të një natyre të qetë nxënësit/et vënë në zbatim njohuritë që morën mbi vëllimin, burimin e dritës dhe dritëhijen. Ata/ato përdorin tonalitetet bardhë e zi në vizatim.<br>Në fund të detyrës, nxënësit/et flasin për punën e tyre, për mënyrën e realizimit dhe për vështirësitë që hasën. Ata/ato shpjegojnë si ndikon burimi i dritës për të kuptuar vëllimin e objektit/ve.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

6. Planifikimi ditor data.................................

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Perspektiva këndore ose me dy pika ikjeje.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Nga perspektiva qëndrore (me një pikë) te perspektiva me dy pika ikje.<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të gjejnë vijën e horizontit dhe pikën e ikjes në imazhin e një kubi të vizatuar në perspektivë. Më pas mësuesi/ja i drejton pyetjen nxënësve/eve se si mund të realizohet kubi në perspektivë duke e parë nga këndi. Mësuesi/ja shfaq imazhin e kubit në perspektivën me dy pika ikje dhe i fton nxënësit/et të diskutojnë duke krahasuar.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon me qëllim për të identifikuar perspektivën lineare qëndrore dhe atë këndore;<br>- reflekton mbi mënyrën sesi e perceptojmë ne hapësirën;<br>- zbulon tiparet dalluese të perspektivës këndore me dy pika ikjeje dhe mënyrën sesi paraqitet në sipërfaqen dydimensionale;<br>- përdor qëllimisht mënyrat e paraqitjes të perspektivës këndore për të arritur rezultatin e dëshiruar;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e paraqitjes së hapësirës në krijim.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- hapësira;<br>- perspektiva këndore me dy pika ikjeje.</td></tr>
</table>

| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë perspektivën lineare qendrore dhe atë këndore;<br>- mjete të tilla, si: laps, letër, vizore, lapsa me ngjyra. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>*Lidhje me fushat kurrikulare*:<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>*Lidhja me temat ndërkurrikulare*:<br>mjedisi. |
|---|---|

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të gjejnë vijën e horizontit dhe pikën e ikjes në imazhin e një kubi të vizatuar në perspektivë. Më pas mësuesi/ja i drejton pyetjen nxënësve/eve se si mund të realizohet kubi në perspektivë, duke e parë nga këndi. Mësuesi/ja shfaq imazhin e kubit në perspektivën me dy pika ikje dhe i fton nxënësit/et të diskutojnë, duke krahasuar. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon perspektivën me dy pika ikjeje, ngjashmërinë dhe ndryshimin me perspektivën qendrore me një pikë ikjeje. Ai/ajo shpjegon që perspektiva me dy pika ikjeje, ashtu si dhe ajo me një pikë ikjeje, është një metodë tjetër për të vizatuar në mënyrë realiste objektet tredimensionale mbi sipërfaqen dydimensionale. Perspektiva këndore kërkon dy pika ikjeje në vijën e horizontit.<br>Veprimtaritë në libër orientojnë nxënësit/et sesi mund të ndërtojnë një objekt nëpërmjet perspektivës me dy pika ikjeje. Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit dhe vështirësitë që hasën. Ata/ato diskutojnë që metoda e perspektivës lineare këndore është një metodë e saktë e paraqitjes së hapësirës mbi sipërfaqen dydimensionale.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

7. Planifikimi ditor data.................................

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Theksi dhe qendra e interesit.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Momenti ose objekti më i rëndësishëm në një imazh ose vepër arti.<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të zbulojnë personazhin ose objektin që bie më shumë në sy në një vepër arti. Më pas mësuesi/ja i pyet ata/ato pse mendojnë se është subjekti më i rëndësishëm. Në cilin pozicion të kuadratit e ka vendosur autori këtë subjekt? Mësuesi/ja pyet nxënësit/et se si veprojnë ata/ato kur duan të theksojnë diçka në veshjen apo edhe në punimin e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon me qëllim për të identifikuar qendrën e interesit në mjedisin rrethues dhe në veprat e artit;<br>- reflekton mbi mënyrën si e perceptojmë theksin apo qendrën e interesit në mjedsin që na rrethon dhe në një vepër arti;<br>- zbulon mënyrat e krijimit të theksit apo të qendrës së interesit në një vepër arti;<br>- përdor qëllimisht theksin në krijim;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë e përdorimit të theksit apo të mungesës së tij në krijim.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- theksi;<br>- qendra e interesit;<br>- mungesa e qendrës së interesit.</td></tr>
</table>

<table>
<tr>
<td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë theksin apo qendrën e interesit si pjesa më e rëndësishme e kompozimit;<br>- materiale të tilla, si: laps, letër, lapsa me ngjyra ose lapustila, revista, letra me ngjyra etj.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>mjedisi;<br>njohja e kulturave.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të zbulojnë personazhin ose objektin që bie më shumë në sy në një vepër arti. Më pas mësuesi/ja i pyet pse ata/ato pse mendojnë se është subjekti më i rëndësishëm. Në cilin pozicion të kuadratit e ka vendosur autori këtë subjekt? Mësuesi/ja pyet nxënësit/et si veprojnë ata/ato kur duan të theksojnë diçka në veshjen apo edhe në punimin e tyre.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon se theksi ose qendra e interesit është një pjesë e kompozimit që bie në sy më shumë sesa pjesët e tjera të tij.<br>Qendra e interesit në një vepër arti mund të ndodhet në qendër të kompozimit ose e mënjanuar nga qendra. Një figurë e vendosur në qendër të kompozimit në përgjithësi tërheq vëmendjen e shikuesit. Kjo mund të arrihet nga përdorimi i një figure me ngjyrë të fortë, i një linje të theksuar, nga përdorimi i kontrastit etj. Në imazhe të ndryshme nxënësit/et identifikojnë mënyrën e realizimit të theksit.<br>Veprimtaritë në libër orientojnë nxënësit/et mbi përdorimin e qendrës së interesit ose jo, në një vepër arti. Ata/ato përzgjedhin të krijojnë qendrën e interesit në ato vende ku ajo mungon.<br>Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të theksit dhe vështirësitë që hasën.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.</td>
</tr>
</table>

8. Planifikimi ditor data................................

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>Tema mësimore: Portreti dhe proporcionet</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Portreti<br>Mësuesi/ja shfaq imazhe të disa portreteve në pikturë, në vizatim, në fotografi dhe në skulpturë. Nxënësit/et ftohen të diskutojnë mbi mënyrën si janë paraqitur këto portrete, cilët janë personazhet aty dhe karakteristikat e tyre (Ky mësim i paraprin projektit që vijon në dy orët e tjera, duke shërbyer edhe si faza e parë e projektit).</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon dhe reflekton mbi portretin si gjini e artit pamor;<br>- zbulon raportet proporcionale të ndërtimit të portretit dhe karakteristikat e shprehjes në portret;<br>- vizaton tiparet e portretit, duke respektuar karakteristikat e tyre;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për karakteristikat shprehëse në portret.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- portreti;<br>- proporcionet;<br>- karakteristikat e shprehjes;<br>- tiparet në portret.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë portretin, përpasat dhe karakteristikat e shprehjes;<br>- materiale të tilla, si: laps, letër, gomë.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>mjedisi;<br>njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Mësuesi/ja shfaq imazhe të disa portreteve në pikturë, në vizatim, në fotografi dhe në skulpturë. Nxënësit/et ftohen të diskutojnë mbi mënyrën si janë paraqitur këto portrete, cilët janë personazhet aty dhe karakteristikat e tyre (Ky mësim i paraprin projektit që vijon në dy orët e tjera, duke shërbyer edhe si faza e parë e projektit). |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se çdo portret ka karakteristika të veçanta, si: formën pak a shumë ovale, pozicionin e syve, të gojës, të hundës e të veshëve.<br>Nxënsit njihen me skemën e ndërtimit dhe me karakteristikat e shprehjes së portretit.<br>Veprimtaria në libër orienton nxënësit/et si të vizatojnë tiparet e portretit, syrin, hundën, gojën, veshin.<br>Pasi mbarojnë vizatimin, nxënësit/et flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të tipareve që ata zgjodhën.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

9. Planifikimi ditor data.................................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**: Projekt. Dielli dhe hëna me portrete njerëzore. | | **Situata e të nxënit: Dielli dhe hëna të personifikuara si njerëz.**<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes imazhe të ndryshme nga periudha të ndryshme ku paraqiten dielli dhe hëna me trajta të portreteve njerëzore. Nxënësit/et diskutojnë mbi shembuj të ndryshëm të personifikimit gjatë historisë. | |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon dhe reflekton mbi imazhe portretesh si personifikim i hënës dhe i diellit;<br>- zbulon raportet proporcionale të ndërtimit të portretit dhe karakteristikat e shprehjes në portret;<br>- vizaton hënën ose diellin të personifikuar në portret njerëzor;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për karakteristikat shprehëse në portret;</td><td>Fjalët kyçe:<br>- portreti;<br>- proporcionet;<br>- karakteristikat e shprehjes;<br>- personifikimi.</td></tr>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë hënën dhe diellin të personifikuara në portrete njerëzore gjatë kohërave të ndryshme;<br>- materiale të tilla, si: laps, letër, gomë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>mjedisi;<br>njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të vëzhgojnë me kujdes imazhe të ndryshme nga periudha të ndryshme ku paraqiten dielli dhe hëna me trajta të portreteve njerëzore. Nxënësit/et diskutojnë mbi shembuj të ndryshëm të personifikimit gjatë historisë.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Nxënësit/et realizojnë skica të ndryshme paraprake të portretit të njeriut duke respektuar përmasat. Ata/ato i japin trajta të diellit ose të hënës, duke u mbështetur në imazhet e ndryshme. Përveç respektimit të përmasave, nxënësit/et kujdesen për shprehjen në portretet që po realizojnë. Këtë e bëjnë duke u mbështetur në shembujt e ndryshëm të mimikës së portretit. Pasi mbarojnë fazën e vizatimit të skicave, nxënësit/et flasin për punën e tyre dhe për mënyrën e realizimit të tipareve që ata zgjodhën.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e:<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

10. Planifikimi ditor data.................................

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
| **Tematika:** Gjuha dhe komunikimi artistik<br><br>**Tema mësimore**:<br>Projekt. Dielli dhe hëna me portrete njerëzore. | | **Situata e të nxënit: Realizimi i portretit**<br>Nxënësit/et e klasës analizojnë përmasat e portretit për të realizuar "diellin" apo "hënën" e tyre. Më pas ata/ato zgjedhin të realizojnë skicën më të mirë duke argumentuar pse (përballë ose në profil). | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon dhe reflekton mbi imazhe portretesh si personifikim i hënës dhe i diellit;*<br>- *zbulon raportet proporcionale të ndërtimit të portretit dhe karakteristikat e shprehjes në portret;*<br>- *vizaton hënën ose diellin të personifikuar në portretin njerëzor;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për karakteristikat shprehëse në portret;* | | **Fjalët kyçe:**<br>- portreti;<br>- proporcionet;<br>- karakteristikat e shprehjes;<br>- personifikimi. | |

<table>
<tr>
<td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë hënën dhe diellin të personifikuara në portrete njerëzore gjatë kohërave të ndryshme;<br>- materiale të tilla, si: laps, letër, gomë, lapsa me ngjyra.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- shkencat e natyrës;<br>- matematika;<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>mjedisi;<br>njohja e kulturave.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nxënësit/et e klasës analizojnë përmasat e portretit për të realizuar “diellin” apo “hënën” e tyre. Më pas ata/ato zgjedhin të realizojnë skicën më të mirë, duke argumentuar pse (përballë ose në profil).</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Nxënësit/et realizojnë vizatimin përfundimtar të diellit ose të hënës së tyre të personalizuar. Përveç respektimit të përmasave, nxënësit/et kujdesen për shprehjen në portretet që po realizojnë. Ata/ato përdorin edhe ngjyrat sipas dëshirës.<br>Pasi mbarojnë fazën e vizatimit dhe ngjyrosjes së portretit nxënësit/et i vendosin të gjitha punimet në mur pranë njëra-tjetrës. Ata/ato flasin për punën e tyre, mënyrën e realizimit të tipareve që ata zgjodhën.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.</td>
</tr>
</table>

11. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Teknika e pastelave | | **Situata e të nxënit: Mundësitë shprëhëse të teknikës së pastelit**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e pastelit dhe mbi mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike. Nëpërmjet eksperimentit ata/ato zbulojnë mënyra të ndryshme të përdorimit të kësaj teknike dhe zgjedhin një mënyrë për të realizuar krijimin tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së pastelave;*<br>- *përdor me kompetencë teknikën e pastelave në krijim;*<br>- *eksperimenton me pastelat, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së pastelit.* | | **Fjalët kyçe:**<br>- pastela;<br>- pastela me bazë vajin;<br>- pastela me bazë dyllin. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të vizatimeve me teknikën e pastelit;<br>- mjete të tilla, si: laps, letër, gomë, pastela. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e pastelit dhe mbi mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike. Nëpërmjet eksperimentit ata/ato zbulojnë mënyra të ndryshme të përdorimit të kësaj teknike dhe zgjedhin një mënyrë për të realizuar krijimin tyre. | | | |

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se pastelet janë shkopinj në formë cilindri ose kuboidi, të bëra me pigmente ngjyrash të bluara dhe të përziera në ujë, me argjilë dhe gomë arabike. Mësuesi/ja shpjegon mënyrat e përdorimit dhe mundësitë shprehëse të teknikës së pastelave.<br>Veprimtaria i udhëzon nxënësit/et të ndjekin hapat për realizimin e vizatimit nëpërmjet kësaj teknike. Nxënësit/et zgjedhin të vizatojnë objekte sipas dëshirës, duke përzgjedhur edhe mjetet shprehëse. Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të tij. Ata/ato kuptojnë mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

12. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Teknika e grafitit me pastelave | | **Situata e të nxënit: Mundësitë shprehëse të grafitit me pastela**<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të bëjnë një eksperimet të thjeshtë me ngjyrat e pastelit. Në një letër ata/ato ngjyrosin me disa ngjyra një hapësirë të vogël të saj e më pas e mbulojnë me pastelin e zi. Me një shkop me majë mësuesi/ja i udhëzon të gërryejnë sipërfaqen. Në këtë mënyrë ata/ato zbulojnë karakteristikat e kësaj teknike dhe diskutojnë se grafiti mund të realizohet mbi materiale të ndryshme. | |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së grafitit me pastela;<br>- përdor me kompetencë teknikën e grafitit me pastela në krijim;<br>- eksperimenton me teknikën e grafitit me pastela, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së pastelit.</td><td>Fjalët kyçe:<br>- grafiti me pastela;<br>- pastela me bazë vajin;<br>- pastela me bazë dyllin.</td></tr>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- Ilustrime të vizatimeve me teknikën e grafitit me pastel;<br>- mjete të tilla, si: laps, letër, gomë, pastela etj.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2" align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja i fton nxënësit/et të bëjnë një eksperimet të thjeshtë me ngjyrat e pastelit. Në një letër ata/ato ngjyrosin me disa ngjyra një hapësirë të vogël të saj e më pas e mbulojnë me pastelin e zi. Me një shkop me majë mësuesja/si i udhëzon të gërryejnë sipërfaqen. Në këtë mënyrë ata/ato zbulojnë karakteristikat e kësaj teknike dhe diskutojnë se grafiti mund të realizohet mbi materiale të ndryshme.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se teknika e graftit realizohet duke gërvishtur me një mjet me majë, mbi një sipërfaqe çfarëdo, në mënyrë që të lërë shenjë pak a shumë të thellë. Mësuesi/ja shpjegon mënyrat e përdorimit dhe mundësitë shprehëse nëpërmjet kësaj teknike në periudha të ndryshme të historisë së artit nëpërmjet përdorimit të mjeteve të ndryshme.<br>Veprimtaria i udhëzon nxënësit/et të ndjekin hapat për realizimin e punimit nëpërmjet kësaj teknike. Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të saj. Ata/ato kuptojnë mundësitë e shumta shprehëse të kësaj teknike.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

# 3.4 Planifikimi tematik për tremujorin e dytë janar-mars

## *Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe*

**Kompetenca e komunikmit dhe të shprehurit**

Nxënësi/ja:

- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike;
- gjykon drejt mesazhet, që u adresohet;
- shprehet qartë dhe saktë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale;
- komunikon qartë mendimin e tij/saj;
- shfrytëzon në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike dhe mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme.

**Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi/ja:

- përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;
- zgjidh në mënyrë të pavarur probleme të ndryshme artistike;
- zhvillon aftësitë për të menduar dhe argumentuar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;
- ndjek me vëmendje udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari artistike.

**Kompetenca e të nxënit**

Nxënësi/ja:

- përzgjedh në mënyrë të pavarur mjetet për të realizuar një krijim artistik;
- përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim;
- zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësi/ja:

- drejton dhe merr pjesë aktive në aktivitete të artit pamor, si brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- kupton dhe gjen zgjidhje në mënyrë të pavarur për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.

**Kompetenca qytetare**
Nxënësi/ja:
- diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
- respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
- bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.

**Kompetenca personale**
Nxënësi/ja:
- krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike;
- merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe në komunitet;
- ndërgjegjëson veten e zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit te të tjerët.

**Kompetenca digjitale**
Nxënësi/ja:
- gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion, si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
- përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit artistik, si: video CD, DVD, aparat fotografik digjital, kamera etj.

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:**
**Krijimi artistik**
Nxënësi/ja:
- përdor ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim; zbulon rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike;
- përdor hapat e procesit krijues, elementet e artit pamor dhe teknikat artistike;
- përzgjedh elementet e duhura për të realizuar idetë artistike në tema të personalizuara;
- përmirëson punën duke u mbështetur tek eksperimenti dhe në zgjidhje të ndryshme artistike;
- analizon burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin e tij/saj krijues;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në krijim, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

**Realizimi i punimit**

Nxënësi/ja:

- përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë në punën dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn;
- krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra, nëpërmjet kujtesës së tij/saj mbi objektet, njerëzit etj., ose nëpërmjet imagjinatës duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike;
- vlerëson eksperiencat e tij/saj krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit;
- zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim;
- eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tij/saj; analizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij/saj krijues;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në lidhje me realizimin e punimit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

**Vlerësimi artistik**

Nxënësi/ja:

- analizon dhe interpreton elementet e gjuhës vizuale, organizimin e tyre, teknikën, gjininë në një vepër arti;
- identifikon dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social kulturor;
- identifikon dhe argumenton aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, të punës së tij/saj dhe të shokut/shoqes, duke shprehur emocionet;
- interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër arti, për një objekt artistik, për punimin e tij/saj dhe atë të shokut/shoqes;
- përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, atë të shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në vlerësimin e veprave të artit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur;
- kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri, në periudha të ndryshme historike;
- identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karierën artistike.

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Teknika dhe procese artistike | Teknika piktorike të përziera | **Dy ose më shumë teknika njëherësh**<br><br>Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të tregojnë eksperiencat e tyre mbi përdorimin e më shumë se një teknike për realizimin e ideve. Nxënësit/et diskutojnë mbi kombinimet e ndryshme që kanë përdorur, kur ato kanë qenë ose jo të suksesshme dhe karakteristikat e tyre. | metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>puna në grup dhe puna individuale;<br><br>hetimi dhe zbulimi;<br><br>zbatime praktike brenda dhe jashtë klase;<br><br>metoda integruese; | Vlerësim diagnostikues:<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vetvlerësim me listë kriteresh;<br><br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues):<br>• vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br>• vlerësimi i punës në grup;<br>• vlerësim mes nxënësish;<br>• vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë;<br>• vlerësimi i detyrave të shtëpisë; | | teksti i artit pamor për klasën VI;<br><br>materiale nga interneti;<br><br>ilustrime veprash arti;<br><br>ilustrime të imazheve nga natyra në përshtatje me tema të caktuara; |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | bashkëbisedim;<br><br>teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues;<br><br>prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK.<br><br>projekte kurrikulare. | • vetvlerësim;<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vëzhgim me një listë të plotë treguesish;<br>• portofol;<br>• prezantim me gojë ose me shkrim;<br>• projekt kurrikular. | | fotografi të objekteve të artit, dizajnit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore;<br><br>slide/ materiale të krijuara nga mësuesit;<br><br>modele të detyrave nga nxënësit. |
| 14 | | Teknika piktorike eksperimentale | **Teknikat eksperimentale me rezultate të papritura**<br><br>Eksperimenti është një metodë që përdoret nga artistët për të gjetur mundësi të reja shprehëse. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të eksperimentojnë, duke pikuar ngjyrë me penel mbi një letër të lagur me ujë. Nxënësit/et zbulojnë që rezultati është i papritur nga njëra letër te tjetra. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | | Teknika e stampimit | **Teknika e stampimit dhe shumëfishimi i imazhit**<br><br>Nxënësit/et diskutojnë për teknikat e ndryshme të stampimit që ata njohin dhe dinë të përdorin, mbi karakteristikat e tyre të veçanta dhe rëndësinë e kësaj teknike në shumëfishimin e imazhit. Ata/Ato diskutojnë për shtypin dhe rëndësinë e tij në përhapjen e imazhit. | | | |
| 16 | | Gjuha fotografike sipas gjinive | **Fotografia si mjet shprehës**<br><br>Mësuesi/ja shfaq imazhe të ndryshme fotografike dhe i fton nxënësit/et të identifikojnë atë që shohin. Ata/Ato identifokojnë peizazhin, portretin, foton e reklamës etj. Nxënësit/et krahasojnë gjinitë e fotografisë me ato të pikturës, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | | Imazhi në reklamë<br><br>10.1.25 | **Reklama si komunikim**<br><br>Nxënësit/et diskutojnë mbi reklamat e ndryshme, si ato televizive edhe reklamat figurative të objekteve të konsumit. Ata/Ato diskutojnë, duke u nisur edhe nga eksperienca e tyre | | | |
| | | | personale, se sa janë ndikuar nga reklama për të blerë një produkt, apo për të kuptuar mesazhin që ajo përcjell. | | | |
| 18 | | Imazhi në reklamë<br><br>10.1.26<br><br>10.1.27<br><br>10.1.28 | **Poster për reklamë**<br><br>Grupet e punës diskutojnë mbi temën e idenë e përzgjedhur për posterin e tyre dhe mënyrën e realizimit. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | | Skulptura. Modelimi me letër | **Modelimi dhe karakteristikat e materialeve për modelim (maska)**<br><br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e modelimit dhe karakteristikat e saj me plastelinë dhe me materiale që ata/ato njohin. Ata/ato diskutojnë gjithashtu mbi teknikën e modelimit me letër dhe karakteristikat e saj. | | | |
| 20 | | Skulptura. Modelimi me letër | **Maska**<br><br>Në orën e dytë të kësaj teme nxënësit/et diskutojnë mbi maskat që kanë realizuar nëpërmjet teknikës së modelimit me letër. Ata/ato diskutojnë që t'u japin karakteristika të veçanta këtyre maskave nëpërmjet ngjyrave, duke parë edhe shembuj të ndryshëm. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | | Skulptura. Gdhendja | **Teknika e gdhendjes dhe mundësitë shprehëse**<br><br>Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë në teknikën e gdhendjes, mjetet dhe materialet që përdoren. Ata/ato vëzhgojnë maska të gdhendura nga kultura të ndryshme dhe diskutojnë për të realizuar një maskë të gdhendur mbi sapun. | | | |
| 22. | | Konstruksioni. Qyteti dhe ndërtesat | **Shprehem nëpërmjet konstruksionit. (Fabrika)**<br><br>Nxënësit/et diskutojnë mbi konstruksionin në arkitekturë, mbi llojet e ndryshme të ndërtesave, materialet dhe lidhjen e formës me funksionin.<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme ata/ato zbulojnë format e fabrikave dhe lidhjen me funksionet. | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 23. | | Skulptura lëvizëse. Punë në grup. Projekt (1) | **Skulptura lëvizëse.**<br><br>Nxënësit/et vëzhgojnë skulpturat e Kalderit, njihen me karakteristikat e punës së tij dhe diskutojnë mbi to. Ata/ato ndahen në grupe, planifikojnë punën dhe diskutojnë mbi idetë. | | | |
| 24 | | Skulptura lëvizëse. Punë në grup. Projekt (2) | **Skulptura lëvizëse**<br><br>Nxënësit/et diskutojnë mbi idetë e tyre për skulpturat lëvizëse, për skicat që kanë realizuar dhe materialet që do të përdorin. Ata/ato diskutojnë mbi mënyrën e bashkimit të pjesëve në mënyrë që të ruajnë ekuilibrin. | | | |

# 3.5 Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (janar-mars)

13. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Teknika piktorike të përziera | | **Situata e të nxënit: Fotografia si mjet shprehës**<br>Mësuesi/ja shfaq imazhe të ndryshme fotografike dhe i fton nxënësit/et të identifikojnë atë që shohin. Ata/ato identifokojnë peizazhin, portretin, foton e reklamës etj. Nxënësi/et krahasojnë gjinitë e fotografisë me ato të pikturës, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikave piktorike të përziera;*<br>- *përdor me kompetencë teknikën e përzier të pastelit me akuarelet në krijim;*<br>- *krijon me teknikën e pastelit dhe të akuareleve, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikave piktorike të përziera.* | | **Fjalët kyçe:**<br>- teknika të përziera piktorike;<br>- laps dhe akuarel;<br>- bojë kinë dhe akuarel;<br>- bajra vaji dhe akuarel;<br>- pastela dhe akuarel. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime veprash me teknika piktorike të përziera;<br>- mjete të tilla, si: pastela dhe akuarela. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>*Lidhje me fushat kurrikulare*:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |

| |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të tregojnë eksperiencat e tyre mbi përdorimin e më shumë se një teknike për realizimin e ideve. Nxënësit/et diskutojnë mbi kombinimet e ndryshme që kanë përdorur, kur ato kanë qenë ose jo të sukseshme dhe mbi karakteristikat e tyre. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se në shumë raste, përdoren teknika të reja në formën e eksperimentit që kur rezultojnë të suksesshme mund të vazhdojnë të përdoren, ose në të kundërt ua lënë vendin eksperimenteve të reja. Në shembujt e veprave të artistëve, nxënësit/et zbulojnë teknikat e përziera që ata/ato kanë përdorur dhe karakteristikat e tyre.<br>Sipas shembullit në libër nxënësit/et mund të vëzhgojnë me kujdes një vepër arti ku është përdorur një teknikë e përzier (vaji dhe akuarelat) dhe të realizojnë edhe ata/ato një detyrë ku në mënyrë të ngjashme të përziejnë pastelat e vajit me akuarelat. Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të tij. Nxënësit/et kuptojnë edhe mundësitë e shumta shprehëse që ofrojnë teknikat e përziera. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

14. Planifikimi ditor data..............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Teknika piktorike eksperimentale | | **Situata e të nxënit: Teknikat eksperimentale me rezultate të papritura**<br>Eksperimenti është një metodë që përdoret nga artistët për të gjetur mundësi të reja shprehëse. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të eksperimentojnë duke pikuar ngjyrë me penel mbi një letër të lagur me ujë. Nxënësit/et zbulojnë që rezultati është i papritur nga një letër te tjetra. | |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikave piktorike eksperimentale;<br>- përdor me kompetencë teknika eksperimentale në krijim;<br>- krijon me teknikat piktorike eksperimentale, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikave piktorike eksperimentale.</td><td>Fjalët kyçe:<br>- teknika piktorike eksperimentale;<br>- përhapja e ngjyrës në letër të lagur;<br>- parafinë ose ngjitës dhe akuarela;<br>- lëngje të papërshkueshëm nga uji;<br>- pastela dhe akuarele.</td></tr>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë teknika piktorike eksperimentale;<br>- mjete të tilla, si: akuarele, ngjitës, laspsa me ngjyra, rapidograf.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2" align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Eksperimenti është një metodë që përdoret nga artistët për të gjetur mundësi të reja shprehëse. Mësuesi/ja orienton nxënësit/et të eksperimentojnë duke pikuar ngjyrë me penel mbi një letër të lagur me ujë. Nxënësit/et zbulojnë që rezultati është i papritur nga njëra letër te tjetra.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon se nën emërtimin “teknika eksperimentale” përfshihen ato teknika, të cilat prodhojnë rezultate të ndryshme mes tyre, por edhe të papritura. Nëpërmjet imazheve, mjeteve dhe eksperimenteve nxënësit/et njihen me teknika të ndryshme eksperimentale dhe me karakteristikat e tyre. Veprimtaritë në libër i udhëzojnë nxënësit/et të provojnë teknika të ndryshme eksperimentale. Pasi përzgjedhin teknikën me të cilën realizojnë punimin e tyre, nxënësit/et zbulojnë të papriturat e teknikës. Ata/ato shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të saj. Nxënësit/et kuptojnë edhe mundësite e shumta shprehëse që ofrojnë teknikat e eksperimentale.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
</table>

| *Vlerësimi i nxënësit* |
|---|
| Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

15. Planifikimi ditor data..............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 3 | **Klasa**: VII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Teknika e stampimit | | **Situata e të nxënit: Teknika e stampimit dhe shumëfishimi i imazhit**<br>Nxënësit/et diskutojnë për teknikat e ndryshme të stampimit që ata njohin dhe që dinë të përdorin, mbi karakteristikat e tyre të veçanta dhe rëndësinë e kësaj teknike në shumëfishimin e imazhit. Ata/ato diskutojnë për shtypin dhe rëndësinë e tij në përhapjen e imazhit. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së stampimit;*<br>- përdor me kompetencë *mjetet e teknikës së stampimit në krijim;*<br>- *krijon me teknikën e stampimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së stampimit.* | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- stampimi;<br>- shumëfishimi i i imazhit,<br>- mail arti. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave grafike të realizuara me teknikat e stampimit;<br>- mjete të tilla, si: bojra uji, mjete të ndryshme stampimi, letra, gërshërë etj. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |
|---|---|
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et diskutojnë pë teknikat e ndryshme të stampimit që ata njohin dhe që dinë të përdorin, mbi karakteristikat e tyre të veçanta dhe rëndësinë e kësaj teknike në shumëfishimin e imazhit. Ata/ato diskutojnë për shtypin dhe rëndësinë e tij në përhapjen e imazhit. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se teknika e stampimit sot, jo vetëm ka një përdorim mjaft të gjerë në përhapjen me shpejtësi të informacionit në të gjitha fushat, por gjithashtu, është një mjet shprehës artistik shumë i rëndësishëm në art dhe dizajn.<br>Nëpërmjet imazheve mësuesi/ja shpjegon mënyrën dhe arsyen e lindjes së "Mail artit", si një formë arti që udhëton me postën, në mjetet e transportit dhe bashkon artistët. Gjithashtu, "Mail arti" është edhe një formë e personalizimit të imazheve të stampuara (për ta bërë atë sa më të veçantë).<br>Duke u mbështetur te "Mail arti" veprimtaria në libër i orienton nxënësit/et të personalizojnë një kartolinë apo një zarf nëpërmjet teksnikës së stampimit. Gjithashtu, nxënësit/et mund të zgjedhin të përdorin teknikën e stampimit për efekte dekorarive.<br>Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të stampës, të imazhit të stampuar dhe mbi qëllimin e përdorimit të teknikës së stampimit.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. | |

16. Planifikimi ditor data..............................

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese artistike<br><br>Tema mësimore: Gjuha fotografike sipas gjinive</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Fotografia si mjet shprehës<br>Mësuesi/ja shfaq imazhe të ndryshme fotografike dhe i fton nxënësit/et të identifikojnë atë që shohin. Ata/ato identifokojnë peizazhin, portretin, foton e reklamës etj. Ata/ato krahasojnë gjinitë e fotografisë me ato të pikturës duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të fotografisë sipas gjinisë;<br>- përdor me kompetencë aparatin fotografik;<br>- realizon fotografi, duke kompozuar elementet brenda kuadratit;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse fotografisë.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br>- gjinitë e fotografisë;<br>- portreti në fotografi;<br>- peizazhi në fotografi;<br>- fotoreportazhi;<br>- natyra e qetë në fotografi;<br>- fotografia për reklamë;<br>- fotografia shkencore;<br>- fotografia eksperimentale.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- fotografi që ilustrojnë gjinitë;<br>- mjete të tilla, si: aparat fotografik digjital, objekte për natyrën e qetë.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4" align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Mësuesi/ja shfaq imazhe të ndryshme fotografike dhe i fton nxënësit/et të identifikojnë atë që shohin. Ata/ato identifikojnë peizazhin, portretin, foton e reklamës etj. Nxënësit/et krahasojnë gjinitë e fotografisë me ato të pikturës, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se ashtu si për pikturën, edhe për fotografnë, për lehtësi studimi është bërë e zakonshme të përdoret një ndarje sipas gjinisë. Nëpërmjet imazheve të ndryshme fotografike nxënësit/et identifikojnë dhe diskutojnë së bashku me mësuesin/en karakteristikat e gjinive të ndryshme të fotografisë.<br>Veprimtaria udhëzon nxënësit/et mbi rëndësinë e kompozimit dhe si të fotografojnë një natyrë të qetë në pika të ndryshme shikimi. Nxënësit/et vendosin natyrën e qetë në klasë dhe fotografojnë. Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin në ekranin e aparatit digjital dhe diskutojnë si ndryshon kompozimi në pika të ndryshme shikimi, por edhe në burime të ndryshme të dritës. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

17. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Imazhi në reklamë<br>**6.0.3**<br>**6.0.4** | | **Situata e të nxënit: Reklama si komunikim**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi reklamat e ndryshme, si ato televizive edhe reklamat figurative të objekteve të konsumit. Ata/ato diskutojnë, duke u nisur edhe nga eksperienca e tyre personale, se sa janë ndikuar nga reklama për të blerë një produkt, apo për të kuptuar mesazhin që ajo përcjell. | |

| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të imazhit në reklamë;*<br>- përdor *me kompetencë teknika të ndryshme artistike për të realizuar një poster për reklamë;*<br>- *krijon një poster për reklamë, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të imazhit në reklamë.* | **Fjalët kyçe:**<br><br>- imazhi në reklamë;<br>- mesazhi i reklamës;<br>- poster. |
|---|---|
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë reklama me mesazhe të ndryshme;<br>- mjete të tilla, si: letër, laps, lapsa me ngjyra, gomë, imazhe fotografike etj (në varësi të teknikës së përzgjedhur). | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi reklamat e ndryshme, si ato televizive edhe reklamat figurative të objekteve të konsumit. Ata/ato diskutojnë, duke u nisur edhe nga eksperienca e tyre personale, se sa janë ndikuar nga reklama për të blerë një produkt, apo për të kuptuar mesazhin që ajo përcjell. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se reklama është një formë e komunikimit nëpërmjet fjalëve dhe imazhit. Mësuesi/ja thekson se reklama krijohet nga imazhet dhe fjalët e mund të përhapet nëpërmjet shtypit (revistave dhe gazetave), nëpërmjet televizorit (spoteve televizive), ose nëpërmjet posterave. Veprimtaria orienton dhe udhëzon nxënësit/et të realizojnë një poster për reklamë. I rëndësishëm është organizimi i punës në grup dhe përzgjedhja e temës së reklamës. Në këtë orë nxënësit/et diskutojnë për temën dhe ndajnë detyrat në grup. | |

| |
|---|
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

18. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Imazhi në reklamë<br>**6.0.5**<br>**6.0.6** | | **Situata e të nxënit: Poster për reklamë**<br>Grupet e punës diskutojnë mbi temën dhe idenë e përzgjedhur për posterin e tyre dhe për mënyrën e realizimit. Gjithashtu, diskutojnë edhe për grupin e njerëzve që kanë zgjedhur për t'iu drejtuar mesazhin. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të imazhit në reklamë;*<br>- *përdor me kompetencë teknika të ndryshme artistike për të realizuar një poster reklame;*<br>- *krijon një poster për reklamë, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të imazhit në reklamë.* | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- imazhi në reklamë;<br>- mesazhi i reklamës;<br>- poster. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që ilustrojnë reklama me mesazhe të ndryshme;<br>- mjete të tilla, si: letër, laps, lapsa me ngjyra, gomë, imazhe fotografike etj (në varësi të teknikës së përzgjedhur). | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>*Lidhje me fushat kurrikulare*:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>*Lidhja me temat ndërkurrikulare*:<br>- njohja e kulturave. | |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Grupet e punës diskutojnë mbi temën dhe idenë e përzgjedhur për posterin e tyre dhe mënyrën e realizimit. Gjithashtu, diskutojnë edhe për grupin e njerëzve që kanë zgjedhur për t'iu drejtuar mesazhin. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Gjatë kësaj ore grupet përqendrohen në realizimin e posterit. Çdo grup ka zgjedhur teknikën e realizimit të tij. Çdo anëtar i grupit realizon detyrën që i është ngarkuar nga grupi. Në fund grupi i bashkon të gjitha elementet (imazhet dhe sloganin) në poster.<br>Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të posterit dhe se si e kanë përdorur imazhin për të përcjellë mesazhin.<br>Punimet ekspozohen në klasë. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

19. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Skulptura. Modelimi me letër | | **Situata e të nxënit: Modelimi dhe karakteristikat e materialeve për modelim (maska)**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e modelimit dhe karakteristikat e saj me plastelinë e me materiale që ata njohin. Ata/ato diskutojnë gjithashtu, mbi teknikën e modelimit me letër, karakteristikat e saj dhe mundësitë shprehëse. | |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit me letër;<br>- përdor me kompetencë materialin e letrës për modelim;<br>- krijon me teknikën e modelimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit me letër.</td><td>Fjalët kyçe:<br><br>- skulptura;<br>- modelimi me letër;<br>- maska.</td></tr>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave në skulpturë të realizuara nëpërmjet teknikës së modelimit me letër;<br>- mjete të tilla, si: letër, vinovil, plastelinë.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi teknikën e modelimit dhe karakteristikat e saj me plastelinë dhe me materiale që ata njohin. Ata/ato diskutojnë gjithashtu, mbi teknikën e modelimit me letër, karakteristikat e saj dhe mundësitë shprehëse.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon se një formë tjetër mjaft interesante e modelimit dhe mjaft e thjeshtë në përdorim është modelimi i letrës së lagur.<br>Mësuesi/ja shpjegon se materiali për modelim realizohet duke përzier copa letrash të lagura me ngjitës, shpjegon mënyrat e përdorimit dhe mundësitë shprehëse. Është një teknikë shumë e thjeshtë në përdorim dhe në momentin që objekti i krijuar me këtë teknikë thahet, mund edhe të pikturohet.<br>Veprimtaria orienton nxënësit/et si të realizojnë një maskë. Në orën e parë nxënësit/et realizojnë maskën e modeluar me letër. Për këtë ata/ato, ose krijojnë një model me plastelinë, ose përdorin një maskë të gatshme.<br>Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të maskës. Maska lihet të thahet për të qenë gati orën e dytë.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

20. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Skulptura. Modelimi me letër | | **Situata e të nxënit: Maska**<br>Në orën e dytë të kësaj teme nxënësit/et diskutojnë mbi maskat që kanë realizuar nëpërmjet teknikës së modelimit me letër. Ata/ato diskutojnë që t'u japin karakteristika të veçanta këtyre maskave nëpërmjet ngjyrave duke parë edhe shembuj të ndryshëm. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit me letër;*<br>- përdor me kompetencë *materialin e letrës për modelim;*<br>- *krijon me teknikën e modelimit, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së modelimit me letër.* | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- skulptura;<br>- modelimi me letër;<br>- maska. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave në skulpturë të realizuara nëpërmjet teknikës së modelimit me letër;<br>- mjete të tilla, si: letër, vinovil, plastelinë, bojra uji. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |

| Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Në orën e dytë të kësaj teme nxënësit/et diskutojnë mbi maskat që kanë realizuar nëpërmjet teknikës së modelimit me letër. Ata diskutojnë që t'u japin karakteristika të veçanta këtyre maskave nëpërmjet ngjyrave, duke parë edhe shembuj të ndryshëm. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Nxënësit/et i japin karakteristika tipareve të maskave që kanë realizuar një orë më parë. Këtë e bëjnë me ndihmën ngjyrave por edhe të materialeve të tjera ndihmëse (letra me ngjyra etj.).<br>Pasi mbarojnë detyrën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të maskës dhe për karakteristikat e tyre.<br>Maska ruhet në portofolin e nxënësit/es. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

21. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Skulptura. Gdhendja | | **Situata e të nxënit: Teknika e gdhendjes dhe mundësitë shprehëse**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë në teknikën e gdhendjes, për mjetet dhe për materialet që përdoren. Ata/ato vëzhgojnë maska të gdhendura nga kultura të ndryshme dhe diskutojnë për të realizuar një maskë të gdhendur mbi sapun. | |

<table>
<tr>
<td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të teknikës së gdhendjes;<br>- përdor me kompetencë mjetet e gdhendjes në krijim;<br>- krijon një maskë me teknikën e gdhendjes, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë shprehëse të teknikës së gdhendjes.</td>
<td>Fjalët kyçe:<br><br>- skulptura;<br>- gdhendja;<br>- gdhendja në dru;<br>- gdhendja ne gur dhe mermer;<br>- gdhendja në materiale të buta.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave në skulpturë të realizuara nëpërmjet teknikës së gdhendjes;<br>- mjete të tilla, si: sapun, thikë (ose bishtin e lugës dhe mjete druri me majë).</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi njohuritë në teknikën e gdhendjes, mjetet dhe materialet që përdoren. Ata/ato vëzhgojnë maska të gdhendura nga kultura të ndryshme dhe diskutojnë për të realizuar një maskë të gdhendur mbi sapun.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon se thelbi i teknikës së gdhendjes është i njëjtë, pavarësisht materialit që përdor artisti. Skulptori e fillon punën me një masë solide, së cilës në mënyrë sistematike i jep formën e duhur. Mësuesi/ja shpjegon mënyrat e përdorimit dhe mundësitë shprehëse të teknikës së gdhendjes me sapun. Nxënësit/et inkurajohen të përdorin teknikën e gdhendjes për të krijuar një maskë. Ata/ato ndjekin hap pas hapi udhëzimet për të realizuar maskën. Pasi mbarojnë detyrën, shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit të gdhendjes së maskës së tyre.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td>
</tr>
</table>

| ***Vlerësimi i nxënësit*** |
|---|
| Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë, duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

22. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Konstruksioni. Qyteti dhe ndërtesat | | **Situata e të nxënit: Shprehem nëpërmjet konstruksionit (fabrika)**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi konstruksionin në arkitekturë, mbi llojet e ndryshme të ndërtesave, materialet dhe lidhjen e formës me funksionin. Nëpërmjet imazheve të ndryshme ata/ato zbulojnë format e fabrikave dhe lidhjen e tyre me funksionin. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *zbulon karakteristikat dhe mundësitë shprehëse të konstruksionit;*<br>- *përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar një konstruksion (fabrikën);*<br>- *krijon, duke përdorur elemente të gjuhës pamore;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mundësitë krijuese, **që ofron konstruksioni;*** | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- konstruksioni;<br>- urbanistika;<br>- ndërtesat;<br>- forma dhe funksioni i ndërtesave. | |

<table>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe që demostrojnë qytetin, ndërtesat, fabrikën;<br>- mjete të tilla, si: pipëza, ngjitës letër, gërshërë, letra me ngjyra.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat e natyrës.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi konstruksionin në arkitekturë, mbi llojet e ndryshme të ndërtesave, mbi materialet dhe lidhjen e formës me funksionin. Nëpërmjet imazheve të ndryshme ata/ato zbulojnë format e fabrikave dhe lidhjen e tyre me funksionin.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon se struktura e çdo qyteti karakterizohet nga rrjeti rrugor, nga ndërtesat që përdoren për banim dhe nga ndërtesat publike, por çdo qytet ka karakteristikat e tij të veçanta. Në përgjithësi struktura e çdo ndërtese dhe forma e saj ka lidhje të ngushtë me funksionin.<br>Nxënësit/et vëzhgojnë konstruksionin e fabrikës dhe diskutojnë lidhjen që ka forma me funksionin e saj. Duke ndekur hap pas hapi procesin, ata/ato realizojnë konstruksionin e fabrikës. Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et shohin rezultatin dhe diskutojnë mbi mënyrën e realizimit.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Vlerësimi i nxënësit<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.</td></tr>
</table>

23. Planifikimi ditor data..............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Skulptura lëvizëse. Punë në grup. Projekt | | **Situata e të nxënit: Skulptura lëvizëse**<br>Nxënësit/et vëzhgojnë skulpturat e Kalderit, njihen me karakteristikat e punës së tij dhe diskutojnë mbi këto karakteristika. Ata/ato ndahen në grupe dhe planifikojnë punën. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *zbulon karakteristikat e skulpturave lëvizëse dhe mënyrën e ndërtimit të tyre;*<br>- *përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar një skulpturë lëvizëse;*<br>- *krijon skulpturën lëvizëse, duke pasur parasysh ekuilibrin;*<br>- *shpreh mendimin e tij/saj për mënyrat e shumta të krijimit dhe të përdorimit të skulpturave lëvizëse.* | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- skulptura lëvizëse;<br>- ekuilibri. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të skulpturave lëvizëse dhe imazhe që demostrojnë mënyrën e ndërtimit të skulpturave lëvizëse;<br>- mjete të tilla, si: shkopinj, fje dhe peshat që mund të jenë letër, plastikë ose kombinimi i të dyjave. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat e natyrës.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et vëzhgojnë skulpturat e Kalderit, njihen me karakteristikat e punës së tij dhe diskutojnë mbi këto karakteristika. Ata/ato ndahen në grupe dhe planifikojnë punën. | | | |

| |
|---|
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se skulpturat lëvizëse janë një lloj strukture e bërë me forma delikate të baraspeshuara, që rrinë pezull dhe lëvizin sipas rrymave të ajrit. Ky projekt artistik mund të realizohet në grup. Çdo grup mund të përbëhet nga 4 ose 5 anëtarë.<br>Në fazën e parë nxënësit/et vëzhgojnë skulptura të ndryshme të lëvizshme. Ata/ato duhet të mbajnë parasysh: *Ndërtimi i një skulpture të lëvizshme fillohet gjithmonë nga pjesa e poshtme.* Më pas ndërtohen nivelet me radhë, duke baraspeshuar çdo degë. Duhet pasur kujdes që pjesët të jenë të lëvizshme dhe të mos përplasen me njëra-tjetrën. Nxënësit/et ndahen në grupe, skicojnë dhe ideojnë skulpturën e tyre lëvizëse sipas një skeme të caktuar. Më pas fillojnë të realizojnë pjesët përbërëse të skulpturës lëvizëse. Ata/ato zgjedhin materialin e degëve dhe të objekteve që do të varen. Pasi kanë përzgjedhur materialin, ata/ato realizojnë objektet që do të varin në çdo anë të degëve. Format dhe ngjyrat e tyre mund të jenë të larmishme, ashtu si edhe materialet e zgjedhura për realizimin e tyre. Degët me objektet e varura bëhen gati për orën e fundit kur do të bëhet edhe montimi përfundimtar i pjesëve të skulpturës lëvizëse. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

24. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Teknika dhe procese artistike<br><br>**Tema mësimore**: Skulptura lëvizëse. Punë në grup. Projekt | | **Situata e të nxënit: Skulptura lëvizëse**<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi idetë e tyre për skulpturat lëvizëse, mbi skicat që kanë realizuar dhe mbi materialet që kanë përdorur.<br>Ata/ato diskutojnë mbi mënyrën e bashkimit të pjesëve, në mënyrë që të ruajnë ekuilibrin. | |

<table>
<tr>
<td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zbulon karakteristikat e skulpturave lëvizëse dhe mënyrën e ndërtimit të tyre;<br>- përdor me kompetencë mjetet e punës për të realizuar një skulpturë lëvizëse;<br>- krijon skulpturën lëvizëse, duke pasur parasysh ekuilibrin;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për mënyrat e shumta të krijimit dhe të përdorimit të skulpturave lëvizëse.</td>
<td>Fjalët kyçe:<br><br>- skulptura lëvizëse;<br>- ekuilibri.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- imazhe të skulpturave lëvizëse dhe imazhe që demostrojnë mënyrën e ndërtimit të skulpturave lëvizëse;<br>- Mjete të tilla, si: shkopinj, fije dhe peshat që mund të jenë letër, plastikë ose kombinimi i të dyjave.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat e natyrës.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nxënësit/et diskutojnë mbi idetë e tyre për skulpturat lëvizëse, mbi skicat që kanë realizuar dhe mbi materialet që kanë përdorur.<br>Ata/ato diskutojnë mbi mënyrën e bashkimit të pjesëve, në mënyrë që të ruajnë ekuilibrin.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Në fazën e fundit nxënësit/et fillojnë të ndërtojnë skulpturën e tyre lëvizëse. Në këtë fazë ata/ato duhet të ndjekin hap pas hapi skemën e ndërtimit e cila i orienton për ruajtjen e ekuilibrit. Gjatë kohës që ata/ato e ndërtojnë, bëjnë prova të ekuilibrit për çdo krah që montojnë. Gjatë punës mësuesi/ja i kujton nxënësit/et se për të ndërtuar një strukturë të lëvizshme pika e ekuilibrit është shumë e rëndësishme.<br>Pasi mbarojnë punën, nxënësit/et varin skulpturat e tyre lëvizëse dhe diskutojnë për mënyrën e realizimit dhe për vështirësitë që hasën.<br>Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td>
</tr>
</table>

*Vlerësimi i nxënësit*
Ky vlerësim do të fokusohet:
▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;
▪ në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;
▪ në mënyrën e realizimit të detyrës;
▪ në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve.

# 3.6 Planifikimi tematik për tremujorin e tretë prill-qershor

## *Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe*

**Kompetenca e komunikmit dhe të shprehurit**
Nxënësi/ja:
- zhvillon personalitetin e vet dhe është aktiv/e në veprimtaritë artistike;
- gjykon drejt mesazhet, që u adresohet;
- shprehet qartë dhe saktë me anë të simboleve, shenjave dhe gjuhës vizuale;
- komunikon qartë mendimin e tij/saj;
- shfrytëzon në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur, kritike dhe krijuese, mjetet artistike e mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në art pamor në mënyrë të pavarur, të vazhdueshme.

**Kompetenca e të menduarit**
Nxënësi/ja:
- përpunon njohuritë vizuale në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi;
- zgjidh në mënyrë të pavarur probleme të ndryshme artistike;
- zhvillon aftësitë për të menduar dhe për të argumentuar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese;
- ndjek me vëmendje udhëzimet për të realizuar një krijim, apo veprimtari artistike.

**Kompetenca e të nxënit**
Nxënësi/ja:
- përzgjedh në mënyrë të pavarur mjetet për të realizuar një krijim artistik;
- përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim;
- zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

**Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**
Nxënësi/ja:

- drejton dhe merr pjesë aktive në aktivitete të artit pamor si brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- kupton dhe gjen zgjidhje në mënyrë të pavarur për problemet ekologjike, duke u ndërgjegjësuar për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

**Kompetenca qytetare**
Nxënësi/ja:

- diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore;
- respekton punën e vet dhe të të tjerëve;
- bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës, për një qëllim të përbashkët.

**Kompetenca personale**
Nxënësi/ja:

- krijon besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike;
- merr pjesë në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe në komunitet;
- ndërgjegjëson veten dhe zhvillon vetëbesimin dhe krijimin e besimit te të tjerët.

**Kompetenca digjitale**
Nxënësi/ja:

- gjen, prodhon, krijon, prezanton dhe shkëmben informacion, si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet;
- përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit artistik, si: video CD, DVD, aparat fotografik digjital, kamera etj.

## *Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës*

**Krijimi artistik**
Nxënësi/ja:

- përdor ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim;
- zbulon rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike;
- përdor hapat e procesit krijues, elementet e artit pamor dhe teknikat artistike;
- përzgjedh elementet e duhura për të realizuar idetë artistike në tema të personalizuara;

- përmirëson punën duke u mbështetur tek eksperimenti dhe në zgjidhje të ndryshme artistike;
- analizon burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin e tij/saj krijues;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në krijim, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

**Realizimi i punimit**

**Nxënësi/ja:**

- përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë në punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn;
- krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet njerëzit etj., ose nëpërmjet imagjinatës duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike;
- vlerëson eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit;
- zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim;
- eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tij/saj;
- analizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij/saj krijues;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në lidhje me realizimin e punimit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur.

**Vlerësimi artistik**

Nxënësi/ja:

- analizon dhe interpreton elementet e gjuhës vizuale, organizimin e tyre, teknikën, gjininë në një vepër arti;
- identifikon dhe vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social-kulturor;
- identifikon dhe argumenton aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, punës së tij/saj dhe shokut/shoqes, duke shprehur emocionet e tij/saj;
- interpreton, argumenton dhe shpreh këndvështrimin e tij/saj për një vepër arti, për një objekt artistik, për punimin e tij/saj, dhe për atë të shokut/shoqes;
- përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe për të komentuar veprat e artit, punën e tij/saj, atë të shokut/shoqes dhe eksperiencën e tij/saj artistike;
- identifikon elemente të eksperiencës së tij/saj artistike, në vlerësimin e veprave të artit, çfarë ka mësuar dhe metodat që ka përdorur;
- kupton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri në periudha të ndryshme historike;
- identifikon një sërë profesionesh që lidhen me artin pamor dhe me karierën artistike.

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 25 | | Verifikoj kompetencat mbi teknikat artistike. | **Konkurs me dy skuadra**<br>Nxënësit/et e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër.<br>Pyetjet janë ndërtuar rreth njohurive të marra në tematikën të dytë.<br>Për të ndërtuar një pyetësor nxënësit/et orientohen nga mësuesi/ja dhe libri. | metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse;<br><br>puna në grup dhe puna individuale;<br><br>hetimi dhe zbulimi;<br><br>zbatime praktike brenda dhe jashtë klase;<br><br>metoda integruese;<br><br>bashkëbisedim;<br><br>teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues;<br><br>prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK.<br><br>projekte kurrikulare. | Vlerësim diagnostikues:<br>• intervistë me një listë tre-guesish;<br>• vetvlerësim me listë krit-eresh;<br><br>Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues):<br>• vlerësimi i përgjigjeve me gojë;<br>• vlerësimi i punës në grup;<br>• vlerësim mes nxënësish;<br>• vlerësimi i aktivitetit gjatë debateve në klasë; | teksti i artit pamor për klasën VI;<br><br>materiale nga interneti;<br><br>ilustrime veprash arti;<br><br>ilustrime të imazheve nga natyra në përshtatje me tema të caktuara;<br><br>fotografi të objekteve të artit, dizajnit, artizanatit dhe trashëgimisë kulturore; |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | • vlerësimi i detyrave të shtëpisë;<br>• vetvlerësim;<br>• intervistë me një listë treguesish;<br>• vëzhgim me një listë të plotë treguesish;<br>• portofol;<br>• prezantim me gojë ose me shkrim;<br>• projekt kurrikular. | slide/ materiale të krijuara nga mësuesit;<br><br>modele të detyrave nga nxënësit. |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 26 | Historia, arti dhe shoqëria | Arti barok | **Zbulojmë artin Barok.** Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Baroke. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. | | | | |
| 27 | | Neoklasicizmi | **Zbulojmë artin neoklasik** Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Neoklasike. Ata/ato njihen edhe me | | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. | | | | |
| 28 | | Romantizmi | **Zbulojmë artin romantik** Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Romantike. Ata/ato njihen me | | | | |
| | | | artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Nxënësit/et krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme. | | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | | Realizmi | **Zbulojmë artin realist** Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Realiste. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Nxënësit/et krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme. | | | | |
| 30 | | Impresionizmi | **Zbulojmë artin impresionist** Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten | | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Impresioniste. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Nxënësit/et krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme. | | | | |
| 31 | | Arti në Shqipëri në fund të shek. XIX | **Zbulojmë artin në Shqipëri në fund të shek. XIX** Nxënësit/et nëpërmjet imazheve njihen me artistët shqiptarë të kësaj periudhe si Marubin, Kol Idromenon etj., | | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | dhe diskutojnë mbi karakteristikat e punëve të tyre. | | | | |
| 32 | | Arti në Shqipëri në fillim të shek. XX | **Zbulojmë artin në Shqipëri në fillim të shek. XX** Nxënësit/et nëpërmjet imazheve njihen me artistët shqiptarë të kësaj periudhe, si Vangjush Mion, Abdurrahim Buzën etj., dhe diskutojnë mbi karakteristikat e punëve të tyre. | | | | |
| 33 | | Veshjet popullore shqiptare | **Veshjet popullore pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore** Nëpërmjet imazheve të ndryshme | | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | nxënësit/ et njihen me veshjet popullore nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, me karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta. Në imazhet e shfaqura ata/ ato identifikojnë veshjet e krahinave që njohin. | | | | |
| 34 | | Album me veshjet popullore. Punë në grup. Projekt | **Album me veshje popullore** Grupet e punës diskutojnë mbi veshjet popullore të krahinave që do të prezantojnë në albumin e tyre dhe mbi të dhënat për çdo veshje. | | | | |

| Nr. | Tematika | Temat mësimore | Situata e parashikuar e të nxënit | Metodologjia e mësimdhënies | Teknikat e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | | Album me veshjet popullore. Punë në grup. Projekt | **Album me veshje popullore** Grupet e punës diskutojnë për mënyrën e organizimit të të dhënave në albumet e tyre dhe për ndarjen e rubrikave. | | | |

# 3.7 Planifikimi ditor bazuar në situata të të nxënit (prill-qershor)

25. Planifikimi ditor data.............................

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Teknika dhe procese artistike<br><br>Tema mësimore: Verifikoj kompetencat mbi teknikat artistike.</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Konkurs me dy skuadra<br>Nxënësit/et e klasës ndahen në dy skuadra dhe secila prej tyre përgatit pyetjet dhe përgjigjet për skuadrën tjetër. Pyetjet janë ndërtuar rreth njohurive të marra në dytë. Për të ndërtuar një pyëtësor nxënësit/et orientohen nga mësuesi/ja dhe libri.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- zhvillon aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese;<br>- komunikon në mënyrë efektive me shokët dhe shoqet e klasës;<br>- përdor fjalorin e përshtatshëm artistik mbi teknikat artistike për të formuluar pyetjet;<br>- diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për ndarjen e punës;<br>- shpreh mendimin e tij/saj për rezultatet e arritura në konkurs nga skuadra.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br><br>- fjalori artistik;<br>- pyetësor;<br>- konkurs.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- fotografi dhe ilustrime nga teknikat artistike dhe vepra të artit që nxënësit kanë gjetur për të formuluar pyetjet.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat e natyrës.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të ndahen në dy skuadra dhe secila skuadër të krijojë një pyetësor mbi njohuritë që ata/ato kanë marrë në tematikën e e dytë. Këtë pyetësor ata/ato do ta përdorin për tia drejtuar skuadrës tjetër. Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të formulojnë pyetjet, duke u mbështetur edhe në rubrikën “Verifikoj kompetencat mbi teknikat artistike” në tekstin e nxënësit. Gjithashtu, çdo skuadër zgjedh njohuritë mbi të cilat do të formulojë pyetjet. Nxënësit/et kanë bërë edhe një punë paraprake të mbledhjes së imazheve që do të jenë pjesë e pyetësorit. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja i orienton nxënësit/et të vendosin rregullat e konkurimit dhe pikët e pyetjeve. Nëpërmjet një shorti ata/ato caktojnë se cila nga skuadrat do të fillojë pyetësorin e para. Gjatë kohës së konkurimit një nxënës/e mbledh pikët dhe kur skuadra që nuk i përgjigjet pyetjes ose i përgjigjet asaj pjesërisht, skuadra tjetër jep përgjigjen dhe argumenton pikët. Në këtë mënyrë vazhdon konkurimi deri në përfundim të pyetësorit. Argumentimi i përgjigjeve dhe i pikëve është shumë i rëndësishëm gjatë konkurimit. Në përfundim të konkurimit përzgjidhet skuadra fituese sipas numrit të pikëve të mbledhura. Nxënësit/et diskutojnë për mënyrën e formulimit të pyetjeve. Çdo skuadër nxjerr konkluzionet e punës në grup dhe tregon nëse bashkëpunimi e arriti rezultatin. Nëse jo duhet të tregojnë se cilat ishin arsyet. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>• në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re;<br>• në vlerësimin e punës së secilit/ës nxënës/e;<br>• në mënyrën e realizimit të detyrës;<br>• në analizën vlerësuese që nxënësit/et i bëjnë punës së tyre dhe punës së shokëve/shoqeve. |

26. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Arti barok (1600-1700) | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë artin barok**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Baroke. Ata/ato diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në histori, pasi mësojnë ku dhe kur lindi arti Barok. Gjithashtu, ata/ato kujtojnë karakteristikat e artit të rilindjes, si paraardhës i artit barok. Nxënësit/et njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. | |

<table>
<tr><td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit barok;<br>- zbulon karakteristikat e artit barok dhe artistët më përfaqësues;<br>- reflekton mbi natyrën e qetë, si një gjini e artit e afirmuar në periudhën e artit barok;<br>- shpreh mendimin e vet rreth gjuhës artistike të artit barok.</td><td>Fjalët kyçe:<br><br>- arti barok;<br>- arkitektura;<br>- piktura;<br>- skulptura;<br>- natyra e qetë.</td></tr>
<tr><td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit dhe të arkitekturës të periudhës së artit barok.</td><td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="2" align="center">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Baroke. Ata/Ato diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në histori, pasi mësojnë ku dhe kur lindi arti Barok. Gjithashtu, ata/ato kujtojnë karakteristikat e artit të rilindjes si paraardhëse e artit barok. Nxënësit/et njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon se Arti barok lindi në Itali dhe u përhap në Evropë gjatë shekullit XVII. Veprat e artit të kësaj periudhe edhe pse me tema fetare shprehin emocione të fuqishme. Në to të bie në sy veprimi dhe lëvizja e personazheve, si: engjëj që fluturojnë, njerëz që luftojnë etj. Shpesh personazhet janë njerëz të thjeshtë që vendosen nën petkun e shenjtorëve.Nëpërmjet imazheve nxënësit/et zbulojnë karakteristikat e veprës së artistëve më përfaqësues të kësaj periudhe. Veprimtaria prezanton natyrën e qetë, si një gjini, e cila i ka fillesat që në periudhën greko-romake por që u afirmua në artin barok. Nxënësit/et reflektojnë mbi mënyrën se si është trajtuar natyra e qetë në periudha të ndryshme të historisë së artit dhe duke e shpjeguar me fjalët e tyre. Punimet ruhen në portofolin e nxënësit/es.</td></tr>
</table>

| ***Vlerësimi i nxënësit*** |
|---|
| Ky vlerësim do të fokusohet:<br>• në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>• në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>• në realizimin e detyrës së dhënë. |

27. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Neoklasicizmi (1765-1850) | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë artin neoklasik**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Neoklasike. Ata/ato diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në histori, pasi mësojnë ku dhe kur lindi arti Neoklasicizmi. Nxënësit/et njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon veprat e artit të periudhës së* artit neoklasik*;*<br>- *zbulon karakteristikat e artit neoklasik dhe artistët më përfaqësues;*<br>- *reflekton mbi karakteristikat e artit neoklasik;*<br>- *shpreh mendimin e vet rreth ideve dhe gjuhës artistike të artit neoklasik.* | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- arti neoklasik;<br>- arkitektura;<br>- piktura;<br>- skulptura;<br>- mendimi iluminist. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të periudhës së artit neoklasik. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |

| Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Neoklasike. Ata/ato diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në histori, pasi mësojnë ku dhe kur lindi arti Neoklasicizmi. Nxënësit/et njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se neoklasicizmi u përhap në Evropë në gjysmën e dytë të shekullit XVII. Artistët u referoheshin formave të antikitetit grek dhe romak. Një ndikim të madh patën zbulimet në Pompei (1748) dhe Erkolano (1719), duke shënuar edhe krijimin e një disipline të re, atë të arkeologjisë. Neoklasicizmi është shprehje e mendimit iluminist.Vepra e artit neoklasik u frymëzua nga parimi i thjeshtësisë dhe ishte në kërkim të një "bukurie ideale", që qëndronte mbi pasionet. Skenat historike të heroizmit dhe të virtytit u përdorën si propagandë patriotike.<br>Nëpërmjet imazheve nxënësit/et zbulojnë karakteristikat e veprës së artistëve më përfaqësues të kësaj periudhe. Veprimtaria prezanton veshjen në periudhën neoklasike. Nxënësit reflektojnë mbi stilin e veshjes dhe e krahasojnë atë me ditët e sotme. Ata njihen edhe me faktin që shpeshherë stili impero, ashtu si veshja në shumë periudha të tjera historike, ka qenë një pikë referimi edhe për stilistët e sotëm. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>• në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>• në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>• në realizimin e detyrës së dhënë. |

28. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Romantizmi (1765-1850) | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë artin romantik**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Romantike dhe mbi mënyrën se si u pasqyrua ai në artet e tjera. Ata/ato diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në histori, pasi mësojnë ku dhe kur lindi arti romantik. Nxënësit/et njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Ata/ato krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme. | |

<table>
<tr>
<td>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit romantik;<br>- zbulon karakteristikat e artit romantik dhe artistët më përfaqësues;<br>- reflekton mbi karakteristikat e artit romantik;<br>- shpreh mendimin e vet rreth ideve dhe gjuhës artistike të artit romantik.</td>
<td>Fjalët kyçe:<br><br>- arti romantik;<br>- piktura;<br>- kapriçot.</td>
</tr>
<tr>
<td>Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të periudhës së artit romantik.</td>
<td>Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Romantike dhe mbi mënyrën se si u pasqyrua ai në artet e tjera. Ata/ato diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në histori, pasi mësojnë ku dhe kur lindi arti romantik. Nxënësit/et njihen edhe me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Ata/ato krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme.</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Mësuesi/ja shpjegon se Romantizmi është një rrymë artistike që përfshiu artin fgurativ, letërsinë, muzikën dhe u përhap në të gjithë Evropën, deri në fund të shekullit XVIII. Romantizmi vlerëson intuitën dhe shprehjen e emocioneve, të cilat e udhëheqin artistin në njohjen e botës dhe të ngjarjeve. Subjektet e veprave të artit përfshinin peizazhet, revolucionin, fenë etj. Mësuesi/ja thekson se artisti u bë zëdhënës i realitetit social dhe politik të kohës së tij, duke lartësuar parimet e identitetit kombëtar përmes pasqyrimit të luftës për liri të popullit që i përkiste.</td>
</tr>
</table>

| |
|---|
| Nëpërmjet imazheve nxënësit/et zbulojnë karakteristikat e veprës së artistëve më përfaqësues të kësaj periudhe. Veprimtaria prezanton grafikat ose kapriçot e Gojës. Nxënësit/et reflektojnë mbi gjuhën e hidhur humoristike që përdor ai për të kritikuar fenomenet. Ata/ato nxiten të përdorin elemente humoristike në një vizatim, për të vënë në pah një dukuri shoqërore problematike. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

29. Planifikimi ditor data..............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Realizmi (1840-1880) | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë artin realist**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Realiste. Ata/ato diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në histori mbi këtë periudhë, si rrjedhojë e ndryshimeve ekonomike dhe sociale. Si u pasqyrua në fushën e arteve dhe letërsisë lëvizja realiste, është pjesë e diskutimeve. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Nxënësit/et krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon veprat e artit të periudhës së* artit realist; | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- arti realist;<br>- piktura;<br>- pasqyrimi i realitetit. | |

| | |
|---|---|
| - *zbulon karakteristikat e artit realist dhe artistët më përfaqësues;*<br>- *reflekton mbi karakteristikat e artit realist;*<br>- *shpreh mendimin e vet rreth subjekteve dhe gjuhës artistike të artit realist.* | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të periudhës së artit realist. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |

**Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve**

***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***

Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Realiste. Ata/ato diskutojnë mbi njohuritë që kanë marrë në histori mbi këtë periudhë, si rrjedhojë e ndryshimeve ekonomike dhe sociale. Si u pasqyrua në fushën e arteve dhe letërsisë lëvizja realiste, është pjesë e diskutimeve. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Nxënësit/et krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme.

***Ndërtimi i njohurive të reja***

Mësuesi/ja shpjegon se Realizmi është një lëvizje e mendimit që përfshin artin dhe letërsinë, e cila u formua në Francë dhe u përhap në të gjithë Evropën. Realizmi interpreton transformimin e thellë social që po ndodhte në Evropë, në dekadat e para të shekullit. Revolucioni industrial solli, jo vetëm ndryshime në ekonomi dhe në prodhim, por edhe disnivele të thella sociale. Nëpërmjet imazheve nxënësit/et zbulojnë karakteristikat e veprës së artistëve më përfaqësues të kësaj periudhe.

Veprimtaria orienton nxënësit/et të zbulojnë dhe të argumentojnë faktet që e bëjnë realiste një pikturë. Nëpërmjet një shembulli ata/ato diskutojnë edhe lidhjen midis teorisë shkencore të "Darvinit" dhe veprës së artit të realist Uinslo Homer. Një shembull mjaft i mirë për të lidhur artin dhe shkencën.

| *Vlerësimi i nxënësit* |
|---|
| Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

30. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**:<br>Impresionizmi(1870-1890) | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë artin impresionist**<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Impresioniste. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Nxënësit/et krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon veprat e artit të periudhës së artit impresionist;*<br>- *zbulon karakteristikat e artit impresionist dhe artistët më përfaqësues;*<br>- *reflekton mbi karakteristikat e artit impresionist;*<br>- *shpreh mendimin e vet rreth subjekteve dhe gjuhës artistike të artit impresionist.* | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- impresionizmi;<br>- piktura;<br>- pointilizmi. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të periudhës së artit impresionist. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore. | |

| | |
|---|---|
| | *Lidhja me temat ndërkurrikulare*:<br>- njohja e kulturave. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve***<br>Nëpërmjet imazheve të shfaqura nxënësit/et nxiten të diskutojnë mbi karakteristikat e artit të periudhës Impresioniste. Ata/ato njihen me artistët më të njohur të kësaj periudhe dhe me veprat e tyre. Nxënësit/et krahasojnë veprat e artit të kësaj periudhe me periudhat e mëparshme. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se Impresionizëm u quajt stili i pikturës plot ngjyra në Francë, në fund të shek. XIX. Impresionistët kërkonin të analizonin efektet e ngjyrës dhe të dritës në natyrë. Ata përpiqeshin të kapnin atmosferën në një moment të caktuar të ditës ose të motit. Nëpërmjet imazheve nxënësit/et zbulojnë karakteristikat e veprës së artistëve më përfaqësues të kësaj periudhe.<br>Veprimtaria i njeh nxënësit/et me karakteristikat e pikturës pointiliste dhe teknikën e punimit. Nxënësit/et nxiten të vëzhgojnë me vëmendje dhe të eksperimentojnë me teknikën e pikëzimit, duke përdorur kombinime ngjyrash të pastra. Më pas ata/ato diskutojnë për rezultatet e arritura. | |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. | |

31. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Arti në Shqipëri në fund të shek. XIX | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë artin në Shqipëri në fund të shek. XIX**<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve nxiten të diskutojnë mbi ngjarjet historike të kësaj periudhe në Shqipëri. Nëpërmjet imzheve të veprave më të njohura të artistëve shqiptarë të kësaj periudhe si Marubi dhe Kol idromeno, ata/ato diskutojnë mbi karakteristikat e tyre. | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon veprat e artit të periudhës s*ë artit së arti në Shqipëri në fund të shek. *XIX;*<br>- *zbulon karakteristikat e artit në Shqipëri në fund të shek. XIX dhe artistët më përfaqësues;*<br>- *reflekton mbi karakteristikat e artit në Shqipëri në fund të shek. XIX;*<br>- *shpreh mendimin e vet rreth subjekteve dhe gjuhës artistike të artit në Shqipëri në fund të shek. XIX.* | **Fjalët kyçe:**<br><br>- arti në Shqipëri në fund të shek. XIX;<br>- fotgrafia;<br>- piktura. |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të periudhës së artit në Shqipëri në fund të shek. XIX. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | |
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve nxiten të diskutojnë mbi ngjarjet historike të kësaj periudhe në Shqipëri. Nëpërmjet imzheve të veprave më të njohura të artistëve shqiptarë të kësaj periudhe si Marubi dhe Kol Idromeno, ata/ato diskutojnë mbi karakteristikat e tyre. | |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se gjatë gjysmës së parë të shekullit XIX, krijimtaria artistike i përkiste stilit bizantin dhe ishte e pasur me ikona dhe objekte të tjera bizantine. Mbas vitit 1880 në artin fgurativ shqiptar flloi një drejtim i ri, i cili ndryshonte nga arti i mëparshëm, për nga tematika, teknikat artistike, stili dhe qëllimi i veprës së artit. Në këtë etapë veprat e artit paraqiten më realiste dhe me frymë kombëtare. Nëpërmjet imazheve nxënësit/et zbulojnë karakteristikat e veprës së artistëve më përfaqësues të kësaj periudhe. Veprimtaria i orienton nxënësit/et të njihen me vlerat dokumentuese të fotografisë së Marubit. Ata/ato orientohen të krijojnë një album fotografik me fotografi të pjestarëve të familjes në kohë të ndryshme, duke filluar nga fotografitë më të vjetra e deri tek ato të viteve të fundit. | |

| |
|---|
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

32. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Arti në Shqipëri në fillim të shek. XX | | **Situata e të nxënit: Zbulojmë artin në Shqipëri në fillim të shek. XX**<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve nxiten të diskutojnë mbi ngjarjet historike të kësaj periudhe në Shqipëri. Nëpërmjet imzheve të veprave më të njohura të artistëve shqiptarë të kësaj periudhe si Vangjush Mio, Abdurrahim Buza etj., ata/ato diskutojnë mbi karakteristikat e punëve të tyre. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon veprat e artit të periudhës së* artit së arti në Shqipëri në fillim të shek. *XX;*<br>- *zbulon karakteristikat e artit në Shqipëri në fillim të shek. XX dhe artistët më përfaqësues;*<br>- *reflekton mbi karakteristikat e artit në Shqipëri në fillim të shek. XX;*<br>- *shpreh mendimin e vet rreth subjekteve dhe gjuhës artistike të artit në Shqipëri në fillim të shek. XX.* | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- arti në Shqipëri në fillim të shek. XX;<br>- piktura;<br>- skulptura;<br>- peizazhi. | |

| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të veprave të artit të periudhës së artit në Shqipëri në fillim të shek. XX. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>*Lidhje me fushat kurrikulare*:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>*Lidhja me temat ndërkurrikulare*:<br>- njohja e kulturave. |
|---|---|

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nxënësit/et nëpërmjet imazheve nxiten të diskutojnë mbi ngjarjet historike të kësaj periudhe në Shqipëri. Nëpërmjet imazheve të veprave më të njohura të artistëve shqiptarë të kësaj periudhe, si Vangjush Mio, Abdurrahim Buza etj., ata/ato diskutojnë mbi karakteristikat e punëve të tyre. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se duke filluar nga vitet 1920, në artin shqiptar pati rëndësi të madhe veprimtaria e artistëve Vangjush Mio, Zef Kolombi, Andrea Kushi, Sadik Kaceli, Abdurahim Buza, Odise Paskali etj. Arti i kësaj periudhe trajton tema nga jeta e përditshme, peizazhe, portrete dhe natyrën e qetë. Nëpërmjet imazheve nxënësit/et zbulojnë karakteristikat e veprës së artistëve më përfaqësues të kësaj periudhe.<br>Veprimtaria i orienton nxënësit/et të njihen me peizazhet e piktorit më të mirë peizazhist të kësaj periudhe Vangjush Mios, me subjektet dhe mënyrën realiste të paraqitjes. Ata/ato nxiten të krijojnë një peizazh me tematikë sipas dëshirës. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

33. Planifikimi ditor data.............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Veshjet popullore shqiptare | | **Situata e të nxënit: Veshjet popullore pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore**<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme nxënësit/et njihen me veshjet popullore nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, me karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta. Në imazhet e shfaqura ata/ato identifikojnë veshjet e krahinave që njohin. | |
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon imazhe me veshje të ndryshme popullore shqiptare;*<br>- *zbulon karakteristikat e veshjeve popullore shqiptare;*<br>- *reflekton mbi karakteristikat e veshjeve popullore nga krahina të ndryshme të Shqipërisë;*<br>- *shpreh mendimin e vet rreth bukurisë dhe larmisë së veshjeve tona popullore, si një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë.* | | **Fjalët kyçe:**<br><br>- veshjet popullore;<br>- veshja me xhubletë;<br>- veshja me tirq;<br>- veshja e Lunxhërisë;<br>- veshja me fustanellë etj. | |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të ndryshme të veshjeve popullore shqiptare. | | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. | |
| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** | | | |

| |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Nëpërmjet imazheve të ndryshme nxënësit/et njihen me veshjet popullore nga krahina të ndryshme të Shqipërisë, me karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta të tyre. Në imazhet e shfaqura ata/ato identifikojnë veshjet e krahinave që njohin dhe diskutojnë për to. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Mësuesi/ja shpjegon se veshja popullore është një nga karakteristikat e veçanta të çdo populli dhe shpreh shijet estetike të një periudhe të caktuar. Ndër gjërat më të bukura që populli ynë ka ditur të krijojë në rrjedhën e historisë së tij, është pikërisht veshja popullore, e cila përbën një aspekt të rëndësishëm të trashëgimisë së tij kulturore. Veshjet popullore ndahen në dy grupe të mëdha: 1) veshje për gra; 2) veshje për burra.<br>Nëpërmjet imazheve nxënësit/et diskutojnë mbi elementet përbërëse dhe karakteristikat e disa nga veshjeve më të njohura popullore (Kjo orë shërben edhe si ora e parë e projektit që do të vijojë në dy orët e tjera).<br>Mësuesi/ja i orienton nxënësit mbi mënyrën se si do të zhvillohet projekti, hapat që do të ndiqen dhe produkti përfundimtar i grupeve.<br>Nxënësit/et ndahen në grupe, përcaktojnë krahinën ku do të kryejnë kërkime mbi veshjet popullore dhe ndajnë detyrat për çdo anëtar të grupit. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

34. Planifikimi ditor data..............................

| **Fusha:** Arte | **Lënda:** Art pamor | **Shkalla:** 4 | **Klasa**: VIII |
|---|---|---|---|
| **Tematika:** Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>**Tema mësimore**: Album me veshjet popullore. Pune në grup. Projekt | | **Situata e të nxënit: Album me veshje popullore**<br>Grupet e punës diskutojnë mbi veshjet popullore të krahinave që do të prezantojnë në albumin e tyre dhe mbi të dhënat për çdo veshje. | |

| | |
|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore**<br>*Nxënësi/ja:*<br>- *vëzhgon imazhe me veshje të ndryshme popullore shqiptare;*<br>- *zbulon karakteristikat e veshjeve popullore shqiptare;*<br>- *reflekton mbi karakteristikat e veshjeve popullore nga krahina të ndryshme të Shqipërisë;*<br>- *shpreh mendimin e vet rreth bukurisë dhe larmisë së veshjeve tona popullore si një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë.* | **Fjalët kyçe:**<br><br>- veshjet popullore;<br>- album me veshje popullore. |
| **Burimet/mjetet/materialet:**<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të ndryshme të veshjeve popullore shqiptare;<br>- mjete të tilla, si: album, imazhe nga revistat, fleta vizatimi, ngjyra etj. | **Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.**<br>***Lidhje me fushat kurrikulare***:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br><br>***Lidhja me temat ndërkurrikulare***:<br>- njohja e kulturave. |

| **Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve** |
|---|
| ***Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve***<br>Grupet e punës diskutojnë mbi veshjet popullore të krahinave që do të prezantojnë në albumin e tyre dhe mbi të dhënat për çdo veshje. |
| ***Ndërtimi i njohurive të reja***<br>Grupet e punës analizojnë të dhënat që kanë mbledhur, si ato me shkrim, ashtu edhe imazhet. Rendisin materialin e mbledhur. Bëjnë skica dhe vizatime te veshjeve, elementeve të veshjeve, dekoracioneve të veshjeve etj. Përgatisin albumin me rubrikat përkatëse. |
| ***Vlerësimi i nxënësit***<br>Ky vlerësim do të fokusohet:<br>▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re;<br>▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor;<br>▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

35. Planifikimi ditor data.............................

<table>
<tr><td>Fusha: Arte</td><td>Lënda: Art pamor</td><td>Shkalla: 4</td><td>Klasa: VIII</td></tr>
<tr><td colspan="2">Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.<br><br>Tema mësimore: Album me veshjet popullore. Pune në grup. Projekt</td><td colspan="2">Situata e të nxënit: Album me veshje popullore<br>Grupet e punës diskutojnë për mënyrën e organizimit të të dhënave në albumet e tyre dhe për ndarjen e rubrikave.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore<br>Nxënësi/ja:<br>- vëzhgon imazhe me veshje të ndryshme popullore shqiptare;<br>- zbulon karakteristikat e veshjeve popullore shqiptare;<br>- reflekton mbi karakteristikat e veshjeve popullore nga krahina të ndryshme të Shqipërisë;<br>- shpreh mendimin e vet rreth bukurisë dhe larmisë së veshjeve tona popullore si një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë.</td><td colspan="2">Fjalët kyçe:<br><br>- veshjet popullore;<br>- album me veshje popullore.</td></tr>
<tr><td colspan="2">Burimet/mjetet/materialet:<br>- teksti i nxënësit;<br>- ilustrime të ndryshme të veshjeve popullore shqiptare;<br>- Mjete të tilla, si: album, imazhe nga revistat, fleta vizatimi, ngjyra etj.</td><td colspan="2">Lidhja me fushat e tjera kurrikulare ose me temat ndërkurrikulare.<br>Lidhje me fushat kurrikulare:<br>- gjuhët dhe komunikimi: letërsia;<br>- teknologjia;<br>- shkencat shoqërore.<br>Lidhja me temat ndërkurrikulare:<br>- njohja e kulturave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Metodologjia/teknikat e përdorura/veprimtaritë e nxënësve/eve</td></tr>
<tr><td colspan="4">Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve<br>Grupet e punës diskutojnë për mënyrën e organizimit të të dhënave në albumet e tyre dhe ndarjen e rubrikave.</td></tr>
<tr><td colspan="4">Ndërtimi i njohurive të reja<br>Grupet e punës plotësojnë albumin e grupit me krahinën përkatëse. Mbi çdo album vizatohet harta e krahinës përkatëse. Pasi ka mbaruar puna për të gjitha grupet, nxënësit/et bashkojnë albumet në një të vetëm. Në këtë mënyrë realizohet albumi i veshjeve popullore shqiptare të klasës.</td></tr>
</table>

| |
|---|
| ***Vlerësimi i nxënësit*** |
| Ky vlerësim do të fokusohet: |
| ▪ në diskutimet që ata/ato bëjnë duke lidhur njohuritë me temën e re; |
| ▪ në pjesëmarrjen e tyre aktive gjatë procesit mësimor; |
| ▪ në realizimin e detyrës së dhënë. |

# 4. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

## 4.1 Metodologjia e të nxënit dhe mësimdhënies bazuar në kompetenca në lëndën e artit pamor

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve/eve, duke i dhënë secilit/secilës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të artit pamor do të thotë që nxënësit/et të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata/ato zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar, nëpërmjet rezultateve të të nxënit dhe tematikave përkatëse mësimore. Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit/et drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia në artin pamor synon gjithë përfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca; mësimdhënien me në qendër nxënësin/en dhe mësimdhënien dhe nxënien e integruar***.

Nxënësit/et e një klase janë të ndryshëm/me, përsa i përket mënyrës se si ata/ato nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/et, të pavarur/a, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënit në artin pamor; • lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë të artit pamor;

- rëndësinë e veprimtarive praktike në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- veçoritë e veprimtarive në mënyrë individuale dhe në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues/e-nxënës/se, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi/ja dhe nxënësi/ja janë plotësues/e të njëri/njëra-tjetrit/tjetrës. Një mësimdhënie e mirëmenduar dhe e mirëplanifikuar krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit/es, ashtu edhe atë të nxënësit/es. Kompetencat e artit pamor, që janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënit, që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve/eve. Ata/Ato janë aktiv/e kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve/eve, mësuesi/ja duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata/ato të ndihen të lirshëm/me dhe të zhdërvjellët/ta për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin pamor.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi/ja të punojë me situata ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si p.sh., "..pse më pëlqen?", "...a duket bukur?", "..çfarë ndodh nëse e vendos objektin më afër?" etj. Në këtë mënyrë ai/ajo inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij/saj dhe të ndërmarrë situata të reja.

Cilësia e mësimdhënies është çelësi për suksesin e fëmijëve në mësimin e artit. Mësuesit/et duhet të inkurajojnë çdo nxënës/e të besojë se do të jetë i/e suksesshëm/me në mësimin e artit, të kuptojnë interesat e nxënësve/eve, nevojat që ata/ato kanë, të ndihmojnë nxënësit/et të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, të rendisin udhëzimet që do të përdorin, duke diferencuar udhëzimet për nxënës/e me nevoja të veçanta; po kështu mësuesit/et duhet t'i stimulojnë dhe t'i inkurajojnë të gjithë nxënësit/et, duke krijuar mjedise ku ata/ato të kenë mundësi për të eksploruar mbi artin pamor në mënyrat që për ta/to janë të rëndësishme.

Mësuesit/et mund ta realizojnë këtë nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, duke nxitur pjesëmarrjen me eksperiencën krijuese dhe me materiale konkrete. Planifikimi i kohës, hapësira e përshtatshme dhe një shumëllojshmëri materialesh janë të rëndësishme për të mbështetur një mësimdhënie efektive. Gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesit/et duhet të sigurojnë një shumëllojshmëri aktivitetesh të bazuara në vlerësimin e nevojave individuale

të nxënësve/eve, në nevojat e grupit dhe në praktikat më të mira mësimore. Gjithashtu, mësuesit/et duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë për zhvillimin e veprimtarive të "Artit pamor", që nxit idetë e reja te nxënësit/et. Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin/en të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë, dhe të arrij të krijojë lidhje integruese me lëndët e tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj nga ana tjetër. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet, gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave pamore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

## 4.2 Materiale dhe burime mësimore

Gjatë zhvillimit të mësimit në lëndën e artit pamor, për realizimin e kompetencave, mësuesi/ja përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në artin pamor, duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit etj., duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e kësaj lënde.

Mësuesi/ja përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër të gjuhës artistike pamore. Mësuesi/ja siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/Ajo u prezanton/sqaron nxënësve/eve përmbajtjet caktuara ose shkathtësitë që ata/ato duhet të performojnë.

Mësuesi/ja u krijon mundësi nxënësve/eve të demonstrojnë apo të prezantojnë me anë të mediave detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësuesi duhet të demonstrojnë drejtpërdrejt gjatë mësimdhënies në lëndën e "Artit pamor". Është shumë e rëndësishme për nxënësit/et e kësaj moshe lidhja midis demonstrimit të mësuesit/es dhe dhënies së mundësisë së përdorimit të njohurive dhe aftësive të tyre në veprimtarinë artistike. Në këtë mënyrë ata/ato do të krijojnë pavarësi në përdorimin e mjeteve nga një nivel në tjetrin. Kur mësuesit/et i duhet të përdorë kontekstin kulturor të artit, duhet të marrë në konsideratë të gjitha format e artit nga e gjithë bota dhe nga kultura të ndryshme.

Programi i "Artit pamor" u jep të gjithë nxënësve/eve mundësinë të zbulojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e një sërë mjeteve e teknikave artistike dhe të vlerësojnë veprat e artit. Klasa duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit në orën e artit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- fotografi të ndryshme që mbajnë informacionin e duhur për eksplorimin e elementeve të artit në natyrë dhe mjedisin rrethues;
- fotografi të objekteve të ndryshme të artizanatit, të trashëgimisë kulturore etj.;
- riprodhime të veprave të artit dhe postera;
- *mjetet audiovizive si:* TV, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD;
- *mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe për të demonstruar vepra të ndryshme arti, artizanati, dizajni etj. Këto burime duhet të diskutohen dhe të vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për artin pamor. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese.
- *mjedisi mësimor:* klasa, kabinetet e artit pamor etj.

# 5. VLERËSIMI

## 5.1. Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar.

**Vlerësimi tremujor**

**Vlerësimi periodik tremujor përfshin:**

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* që del nga evidencat e vlerësimit të vazhduar të mbajtura për periudhën tremujore.
- *Vlerësimin me detyr*ë përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.
- *Vlerësimin e dosjes (portofolit) së nxënësit/es* për periudhën tremujore.

Këto vlerësime shënohen në regjistër në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

**Vlerësimi përfundimtar**

Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor. Nota vjetore përfundimtare përfshin:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhdueshëm* të tri periudhave tremujore.
- *Notën vjetore të vlerësimit me detyrë përmbledhëse* të tri periudhave tremujore.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit/es* të tri periudhave tremujore.

Secili lloj i vlerësimit në notën vjetore përfundimtare ka peshën e vet në përqindje.

Tabela: Peshat në përqindje të llojeve të vlerësimit

| **Lloji i vlerësimit** | **Pesha në përqindje** |
|---|---|
| Vlerësimi i vazhdueshëm | 40% |
| Vlerësimi me detyrë përmbledhëse | 40% |
| Vlerësimi i dosjes (portofolit) së nxënësit/es | 20% |

Hapat për njehsimin e notës vjetore përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NVV).
- Përcaktohet nota vjetore e detyrës përmbledhëse (NVP).
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit/es (NVP).
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh: nota 6.4 rrumbullakoset 6; nota 6.5 rrumbullakoset 7).

**(NVV x 0.4) + (NVP x 0.4) + (NVP x 0.2) = Nota vjetore përfundimtare**

*Shembull:*

| **Tremujori I** | | | **Tremujori II** | | | **Tremujori III** | | | **Nota vjetore** | | | **Nota vjetore përfundimtare** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| NVV | NVT | NVP | NVV | NVT | NVP | NVV | NVT | NVP | NVV | NVT | NVP | |
| 8 | 9 | 10 | 9 | 10 | 10 | 8 | 10 | 10 | 8 | 10 | 10 | |

(8 x 0.4) + (10 x 0.4) + (10 x 0.2) = 9.2

**Nota vjetore përfundimtare 9**